



2014

RAPORT- TM₁ -2014



K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A

Rr. Wesley Clark p.n. Prizren 20000

www.hidroregjioni-jugor.com


PËRMBAJTJA	2
Zonat e përgjegjësisë së K.R.U. „HIDROREGJIONI JUGOR”	4
I. AKTIVITETET E PËRGJITHSHME	5
II. RAPORTI I SHËRBIMIT TEKNIK	6
2.1 Aktivitetet – Janar-Mars 2014	6
2.2 Aktivitetet e Shërbimit Teknik për eliminimin e humbjeve teknike	8
2.3 Zyra për planifikim dhe zhvillim	9
2.4 Analizat Fiziko-Kimike dhe Bakteriologjike	11
III. RAPORT I SHËRBIMIT RAJONAL PËR KONSUMATORË	17
3.1 Aktivitetet nga Shërbimi Rajonal Për Konsumatorë	17
3.2 Aktivitetet e shërbimit për informim	21
3.3 Pengesat në realizimin e objektivave	24
3.4 Planet për të ardhmen	24
IV. RAPORT I DEPARTAMENTIT ADMINISTRATIV	25
4.1 Aktivitetet - Janar-Mars 2014	25
4.2 Aktivitetet e zyrës së Teknologjisë Informative	32
V. RAPORT I SHËRBIMIT FINANCIAR	33
5.1 Aktivitetet - Janar-Mars 2014	33
5.2 Shpenzimet – Janar-Mars 2014	34
5.3 Raport i performances- Janar-Mars 2013/2014	35
5.4 Raport i performances dhe realizimi i civeve Janar-Mars 2014	45
5.5 Raport i performances- TM4-2012 - TM1- 2013	43
VI. RAPORT I AUDITORIT TË MBRENDSHËM	51

ORGANOGRAMI

SHTESA I: Raporti I Auditorit të Jashtëm

SHTESA II: Raporti I investimeve

ZONAT E PËRGJEGJËSISË SË K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR“ SH.A



I. AKTIVITETET E PËRGJITHSHME

FURNIZIMI

Edhe pse prurjet e ujit në burimet e vjetra me gravitet kanë rënie të madhe, por falë shtimit të kapaciteteve të reja të ujit përmes shpimeve të puseve në lokacionin të „40 Burimet“ kemi arritur të kemi gjendje stabile të furnizimit me ujë për të gjithë qytetin e Prizrenit duke u furnizuar nga puset e reja (tek 40 burimet) dhe shpimet e puseve të reja janë realizuar me qëllim për t'i zëvendësuar rëniet e prurjeve të ujit nga burimet e vjetra.

Kompania është angazhuar dhe ja ka arritur që në TM-1 të vitit 2014 të furnizojë të gjithë konsumatorët me ujë të pijes 24 orë në përjashtim të zonave të larta të cilat furnizohen me sistem të pompimit ku dhe kemi reduktime të shkurtra brenda ditës (*Kryesisht Laxha Dardania*). Në Njësitë tjera si në Malishevë, Suharekë dhe Dragash nuk ka pas probleme me furnizim më ujë të pijes dhe duke u bazuar në raportet e Njësite Operuese kemi pas furnizim të rregullt me ujë të pijes.

UJI I PRODHUAR

Për TM-1 të 2014 në nivel regional janë raportuar prodhim të ujit **4,196,017.00 m³**, krahasuar nga TM-1 2013 kemi një rënie të prodhimit të ujit të pijes prej **361,384 m³** . (-7.93%) Janë duke vazhduar aktivitetet në sigurimin e burimeve të reja të ujit të pijes, në kaptimin e këtyre sasive të reja si dhe injektimin e kësaj sasive në rrjetin shpërndarës .

FATURIMI

Në periudhën e TM1 2014 janë faturuar 1,658,146 m3, apo 7.7% më pakë se në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (TM1 2013- 1,797,185 m3)
Faturimi në Euro në TM1 2014 ka qenë 936,640.45€, në krahasim me TM1 2013 ka pas një rënie prej 5.5%

INKASIMI

Në periudhën e TM1 2014 janë inkasuar 742,764.37€, apo 5.4% më shumë se në periudhën TM1 2013.
Përqindja e inkasimit ishte 79.24% ose 8.7% më e lartë se në periudhën TM1 2013

UJI I PAFATURUAR

UPF vazhdon të mbetet një sfide kryesore e të gjitha shërbimeve të kompanisë, ku në bashkëpunim me të gjitha shërbimet si dhe duke ju falënderuar donatoreve të huaj dhe institucioneve vendore kemi planifikuar shumë aktivitete kryesisht në zvogëlimin e UPF-se.

Kompania në nivel regional ka shtuar aktivitetet kryesore për zvogëlimin e UPF-se që nënkupton parandalimin e keqpërdorimeve dhe rregullimin me kohe të defekteve në tërësi.

Shërbimi Teknik me të gjithë sektorët e tij është duke evidentuar të gjitha rrjedhjet dhe me të gjitha kapacitetet është duke u përpjekur për rregullimin e tyre sa më të shpejtë. Kompania është duke i vazhduar aktivitetet për zvogëlimin e UPF-se dhe rritjen e kapaciteteve të ujit të pijes.

Raportet tregojnë që UPF në nivel regional për TM-1 është **60.48%** ose **0.85 %** më shumë humbje nga muaji TM-4 të vitit 2013.

Faturimi ne nivel regjional është prej **1,658,420.00 m³** me një rënie te faturimit prej **117,413.00 m³** krahasuar nga TM-4 të vitit 2013.

SHPENZIMET

Shpenzimet në periudhën e TM1 2014 arrin në 797,920.78 € apo 5.4% më të larta se në periudhën TM1 2013. Në këtë kanë ndikuar sidomos rritja e pagave prej 5.47% . (17 punëtorë te rinj), rritja e shpenzimeve të mirëmbajtjes dhe riparimet +3.48%

MBULIMI OPERATIV

Mbulimi operativ për periudhën TM1 2014 ishte 0.93 apo relativisht e njëjtë me periudhën e njëjtë të vitit 2013 (Me një ndryshim prej -3,457.92€)

II. RAPORT I SHËRBIMIT TEKNIK

2.1 Aktivitetet - Janar - Mars – 2014

*Aktivitetet e shërbimit Teknik ne nivel regjional kanë qene te pareshtura dhe janë orientuar ne mundësinë e furnizimit sa me te rregullt me ujë te pijes për te gjithë konsumatorët qe kjo kompani i mbulon, si dhe ne aktivitetet teknike për uljen e humbjeve si atyre teknike po ashtu dhe atyre administrative respektivisht uljen e vlerave te UPF-se.

*Duke u bazuar ne raportet e prodhimit te ujit niveli i ujit ne burime e vjetra ka pasur rënie te dukshme, qe jemi te detyruar te bëjmë hulumtime të reja edhe për shpimet në objektet e vjetra te kompanisë sonë, me qellim për t'i zëvendësuar humbjet në burimet ekzistuese.

*Gjatë TM-1 furnizimi me ujë ka qene i rregullt 24 orë duke iu falënderuar aktivitetëve me rastin e shpimit të puseve ne lokacionin e Bunarit II ku edhe pse kemi rënie të prurjeve natyrore, kemi arritur të kemi shtim te kapaciteteve duke rikthyer furnizimin të rregullt 24 orë me ujë për lagjen Tususit.

*Në njësinë punuese ne Prizrenit gjatë TM-1 ka pasur aktivitete në ndërhyrjet në rrjetin e ujësjellësit me 221 raste, si dhe 109 raste ne rrjetin e kanalizimit: eliminimin e defekte ne rrjetin sekondar, rrjetin primar, , pastrimi dhe fryrje te rrjetit me kompresor, kontrollimi dhe pastrimi i pusetave, kontrollime te kanalizimit dhe pastrime te kanalizimit, riparime te rrugëve etj.

*Gjatë këtij TM-1 kanë vazhduar me punimet tek 40 puset ku është përfunduar kanali si dhe ndërtimi i murit mbrojtës, rregullimi dhe rrafshimi i terrenit, vendosjen e pompave etj.

*Në këtë TM-1 kanë filluar punimet për shpimin e puseve tek livadhi ne afërsi tek 40 burimet ku kanë rezultuar të jen të suksesshëm.

* Në takim me menaxhmentin e „Hidroregjionit“ kohë më parë jemi akorduar për shkak të keqpërdorimit të ujit të pijes nga disa konsumator, lagje ose fshatra të mos ketë furnizimi të rregullt me ujë të pijes aty ku humbjet janë të mëdha në baze të matjeve nga ujëmatësit zonal, këto zona do të aplikohen në të gjithë regjionin e Prizrenit.

*Gjatë TM-1 është bërë mbushja dhe testimi i rezervarëve, mbushja e rezervarit me ujë është bërë nga dy pusët, duke rezultuar në gjendje të rregullt, po ashtu është bërë edhe testimi i gypit të ujësjellësit nga rezervari "Krismat e Sali Shabanit" deri në Gelanc duke u mbushur me ujë gypi DN-315 dhe është bërë testimi pjesë – pjesë.

* Sa i përket Projektit Grumbullimi dhe Trajtimi i Ujerave të Zeza tani me është kompletuar dokumentacioni dhe janë kompletuar të gjitha dokumentacionet teknike nga ana e zyrës konsulente, janë njoftuar të gjitha kompanitë të cilat janë para kualifikuar për fazën e II-te të projektit. *(Për më gjerësisht raportin Kryetari i Komitetit të Projektit Lulzim Paçarizi dhe e posedojmë raportin periodik në të cilin janë përshkruar të gjitha aktivitetet në lidhje me këtë projekt).*

*Gjate kësaj periudhe (30.01.2014) është nënshkruar kontrata në mes kryetarit të komunës të Dragashit, Hidroregjionit jugor dhe përfaqësuesit të fshatit Brezne për marrjen në menaxhim sistemin e furnizimit me ujë. Pas marrëveshjes ekipet tona kanë dalë në teren dhe kanë verifikuar gjendjen, duke lidhur kontrata, ndërrimet e ujëmatësve, bllobimët etj.

*Departamenti teknik ka bërë të gjitha përgatitjet për të zgjidhur problemin e ujit të pijes për qytetin e Prizrenit dhe ka bërë projekte ideore dhe shumë të përafërt, me qëllim që këto projekte ideore të prezantohen në një të ardhme, asamblesë komunale në Prizren.

*Gjatë TM-1 janë bërë leximet e ujëmatësve zonal me qëllim për të verifikuar harxhimet e ujit nëpër zonat e veçanta.

*Kemi pas takime të ndryshme me donatorët potencial si IRD-ne, CDI-ne, me përfaqësues të komunave dhe është përgatitur lista e projekteve ideore të cilat i disponon kompania jone.

*Grupi punues i prezantimit për JICA i cili do të përgatis planin e veprimit për të paraqitur përvojat e marra në Japoni për zhvillimin e kapaciteteve në lëminë e trajtimit të ujerave të zeza, me ç'rast dhe si grup punues kemi pas takime në MZHE, ku dhe janë ndare detyrat dhe janë përcaktuar datat e mundshme të prezantimit.

*Vlen të përmendet takimi me përfaqësuesen kryesore të USAID z. Peri me të cilën është akorduar procedimi i projektit për fshatin Drenoc K. Malisheve, me ç'rast dhe është akorduar se projektin duhet ta vazhdojë IRD-si implementuese e fondeve të USAID dhe është akorduar që pas projektit detaj të cilin do ta përpilojë IRD të kemi një takim dhe të bisedojmë për procedurat e mëtutjeshme të projektit. Projekti i IRD-se do të përfundojë kah fundi i muajit Maj që nënkupton se të gjitha mjetet që i ka në dispozicion IRD për projektin e fshatit Drenoc duhet të implemtohen deri në fund të muajit Maj. Me këtë rast në kemi planifikuar agjendën për një takim të mundshëm në muajin shkurt me K. Te Malisheves dhe me IRD-ne ku dhe do të përcaktohet në mënyrë formale procedimi i këtij projekti.

*Në kuadër të Strategjisë Kombëtare për ujë në takim me Vera Muhaxherin është dërguar lista e projekteve prioritare në nivel regional. Në këtë listë është specifikuar edhe projekti i Diges së Manastirices i cili me një kapacitet prej 1,000,000 m³ je të deponuar do të ishte një zgjidhje me afatgjatë për furnizimin me ujë të

pijes për qytetin e Prizrenit. Ky projekt i njëjte me kërkesë të MZHE-se është proceduar edhe për BERZH-Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim.

*Gjatë TM-1 është nënshkruar marrëveshja me fshatin Billush, me ç'rast fshati Billush është futur nën menaxhim të KRU"HRJ", me rastin e takimit kemi akorduar që inxhinieret e kompanisë të bëjnë një studim tekniko-financiar të gjendjes së këtij fshati.

*Takim në Malisheve me përfaqësues të IRD, HRJ dhe Komunës, ku është diskutuar për projektin e fshatit Drenovc në theks të veçante është diskutuar mundësia e zgjidhjes sa më të mirë teknike të dizajnit.

*Takim me drejtorin e shërbimeve publike në Suharekë me ç'rast është diskutuar për mundësinë e pagesës për puset në Baqevëc si dhe është diskutuar për projektet e mundshme të përbashkëta me komunën në sektorin e ujërave.

2.2 Aktivitet e shërbimit teknik për eliminimin e humbjeve teknike

- ✚ Identifikimin dhe mënjanimin e lidhjeve ilegale,
- ✚ Rehabilitimin e rrjetit të vjetër të qytetit për eliminimin e humbjeve teknike – detektimi i rrjetit të ujës-jellës dhe ndarja e zanave për detektim.
- ✚ Sensibilizimin e të gjithë konsumatoreve për mos keqpërdorim të ujit të pijes ermes, fletëpalosjeve, informatave mediale dhe atyre të shkruara,
- ✚ Ngritjen e vetëdijes të të grithe konsumatoreve që ta paguajnë ujin në mënyrë që të rritet inkasimi dhe të kemi mbulueshmëri financiare e cila do të kthehet konsumatoreve në shërbime dhe investime për shërbim sa më efikas të furnizimit me ujë të pijes.

Tabela.1 Prodhimi i ujit m³ – TM-1, 2014

Muaji	Prodhimi mujor m ³	Prodhimi ditor- m ³	Prodhimi (l/sec)	Komente
Prizren	3,245,450.00	36,060.56	417.4	
Suharekë	516,305.00	5,736.72	66.4	
Dragash	97,310.00	1,081.22	12.5	
Malishevë	336,952.00	3,743.91	43.3	
Total	4,196,017.00	46,622.41	539.6	

Tabela 2. Mirëmbajtja e rrjetit – Sanimi i defekteve TM-1, 2014

Njësia Operative	Ujësjetësi- uji i pijes	Kanalizimi	Total
Prizren	221	109	330
Suharekë	88	16	104
Dragash	16	0	16
Malishevë	79	10	89
Total	404	135	539

2.3 Zyra për planifikim dhe zhvillim TM-1

Për periudhën që po raportojmë në kuadër të zyrës së Plan Zhvillimit grupet e organizuara të cilat veprojnë në terren kanë vazhduar bllobimet nëpër qytetin e Prizrenit për të kryer refreshimin këto kanë arritur këto rezultate: Ujëmatës të bllobuar 304 Ujëmatës, Kontrata të nënshkruar 304 Kontrata, Konsumatorët që ekipa jone nuk ka pasur qasje 507 konsumator, Konsumatorët që ekipa konstaton që duhet të zëvendësohet ujëmatësi 14, Nuk ka pasur konsumator për shkak kushteve teknike që nuk janë bllobuar, Konsumator pa ujëmatës 09, Konsumator që duhet regjistruar 01, Rekorder të reja për blockmapping 395, Refreshim të hartë 164, Konsumator që nuk kanë lidhje uji 54, Konsumator me ujëmatës të bllokuar 03, Bllobim për here të dyte 41, Aktivizim i fatures të konsumatorit 42, Ujëmatës të bllobuar më heret 67.

	Prizren Total –Gjithesëj	Total
1	Bllombim-Kontrata	304
2	Dera Mbyllyr(Herën e dyte)	507
3	Ujëmatës të bllokuar	03
4	Pa ujëmatës	09
5	Zëvendësime	14
6	Nuk kanë lidhje të ujit	54
7	Rekorder të reja për blockmapping	395
8	Refreshim të hartë	164
9	Bllombim për here të dyte	41
10	Duhet regjistruar	01
11	Bllombimet e më hershme	67
12	Aktivizim i fatures	42

Aktivitetet kryesore:

*Bllombim në fshatin : Kushnin - Aktivitetet të konsumatorit: Bllombim për here të dyte 29.

*Në muajin Janar, grupi i bllobimit po ashtu kanë dalë në terren ku kanë bërë nënshkrime të kontratave të konsumatorit, nën menaxhimin e Hysni Ahmetit, menaxher për konsumator.

*Demontim, Montim, Instalim në fshatin : Brezne komuna Dragash.

Aktivitetet:

Demontim-Montim, Kontrata, Bllombime: Ujëmatës $\frac{3}{4}$ = 106 copë, Ujëmatës $\frac{1}{2}$ = 62 copë, Ujëmatës 1" = 03 copë, Instalim, Kontrata, Bllombime: Ujëmatës $\frac{3}{4}$ = 47 copë, Ujëmatës $\frac{1}{2}$ = 11 copë. Totali i ujëmatësve në fshatin Brezne-Dragash: 229 ujëmatës

*Ne muajin Mars ka filluar Refreshimi i Hartes 7F121111:Bllobim-Kontrata03, Dera Mbyllyr (Heren e dyte) 16, Te bllobuar me heret 24, Zavendsime 01, Rekorde te reja per blockmapping 07, Bllobim per here te dyte 04

*Takim ne Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor ne Prishtine.

*Ne muajt Janar-Mars,grupi i terenit demontim – montim me njesi ne Prizren kane arritur qe gjithesej te demontojne dhe montojne 360 ujematesa.

*Grupi i dedektimi të rrjetit të ujësjellësit ka bërë gjithësej 131 detektime, gjatë detektimit kanë hasur në 74 defekte. Po ashtu gjatësia e rrjetit të dedektuar është 14,421 m.

*Ne muajin Janar jane 10 raste,qe vete konsumatorët i kane sjelle ujematesat per servisime dhe riparim ne zyret e Bazhdarimit

*Është bërë leximi dhe monitorimi i ujëmatësave zonal për këtë muajt Janar-Mars,ku ujematesi zonal ne pikat matese: Fehmi Lladrovci,Te ETC-ja,Jusuf Gervalla duhet te kontrollohen per arsye te leximit te vogel, pikat tjera jane kontrolluar dhe rezulton se te gjithë ujematesat jane ne gjendje te rregullt per keta muaj.

Sherbimi i mirëmbajtjes– servisimi i ujematesave – TM-1, 2014

Ky sektor është në kombinim edhe me ekipen e mirëmbajtjes së pompave dhe detektimit. Ky shërbim bënë servisimin dhe kalibrimin ujëmatësave të profileve $\Phi(13-100)$ mm.

Tabela.3 Ndërrimi i ujëmatësave – Janar-Mars 2014

Njësia Operative	Profili \emptyset mm	Sasia / copë	Vërejtje
Prizren	1/2"	117	Stacioni i autobusave:Demontimi i ujëmat.Ø80-montimiØ50,,Rudina“ export-import:Demontimi i ujëmat.Ø100-mont.Ø6/4“ Për „Radoniq“-i - shërbim(riparim)1 ujëmat.1/2“, 1- 3/4“ dhe 1-1“+ 1 ekspertiz 3/4“,Ujëmat. e riparuar për depo-n e kompanis H.R.Jugor:-30 copa 1/2"-30 copa 3/4" Ujëmat. e riparuar për K.R.U. „Radoniq“:-20 copa 3/4" njës.oper.Prizren-43 copa 3/4“ njës.oper.Rahov.
	3/4"	195	
	1"	26	
	5/4"	01	
	6/4"	01	
	Gjithsejt:	340	
Suharekë	1/2"	0	
	3/4"	0	
	1"	0	
	Gjithsejt:	0	
Dragash	1/2"	36	F. BREZNA - 171 të demontuara për riparim - 95 të riparuar
	3/4"	58	
	1"	01	
	Gjithsejt:	95	
Malishevë	1/2"	0	
	3/4"	0	
	1"	0	
	Gjithsejt:	0	

435 copa + 60+ 63 Totali: 558 riparime

KOMENTET:**Analizat bakteriologjike për Njësinë Prizren****Janar,2014**

Nr I përgjithshëm I analizave bakteriologjike ka qenë 84 prej të cilëve 25 analiza nuk I janë përgjigjur standardeve të ujit të pijes. Në lidhje me këtë çështje kemi pasur kontakte të drejtpërdrejta me mjekët profesional të ngarkuar me këtë çështje si dhe është informuar edhe IKSHP-ja Prishtinë dhe se mendimi I Dr.B.Nushi ka qenë se mund të ketë ndonjë infektim sekondar në ato vende ku janë marrë mostrat. Me insistimin tonë në vendet e mostrimit ku nuk I janë përgjigjur standardeve të ujit të pijshëm I kemi përsëritur së bashku me stafin e ISHP-së dhe rezultatet kanë qenë konform standardeve të ujit të pijes(shih raportin për Janar). Këtë çështje kemi diskutuar disa herë edhe në Bordin e Ndërmarrjes si dhe me Komitetin për Hulumtime dhe Teknologji;

Shkurt,2014

Nr I përgjithshëm I analizave Bakteriologjike ka qenë 64 prej të cilëve 19 nuk I janë përgjigjur standardeve të ujit të pijes. Në lidhje me këtë çështje përsëri kemi kontaktuar si me ISHP-në Prizren ashtu edhe me IKSHP-në Prishtinë ku për vizitë kanë qenë Dr.Burbuqe Nushi si dhe Afrim Lajqi, Koordinator në Ministri për çështje të ujit të pijshëm. Në mbledhje debatuam përveç për Udhëzimin Administrativ ashtu edhe për analizat e ujit të pijshëm(ju kam dërguar raportin e mbledhjes si dhe Komitetit për Hulum.dhe Teknol.) I pranishëm ka qenë edhe Kryeshefi Ekzekutiv me ç'rast I kemi prezantuar brengat tona në lidhje me këto analiza që nuk I përgjigjen standardeve të ujit të pijes. Përsëri në lidhje me këtë çështje kemi biseduar në mbledhjen që ka organizuar Komiteti për Hulumtime dhe Teknologji. Në këtë periudhë kohore ka pasur si mungesë të ujit ashtu edhe ndërprerje të shpeshta të ujit për shkak të reshurave të shiut.

Mars,2014

Nr. I përgjithshëm I analizave Bakteriologjike ka qenë 80 prej të cilëve 2 nuk I janë përgjigjur standardeve të ujit të pijes.

Për shkak të ndjeshmërisë së situatës ekipi për monitorim të kualitetit të ujit në mënyrë permanente ka përcjellur gjendjen e cilësisë së ujit si në teren ashtu edhe në laboratorin e Hidroregjionit Jugor.

Shënim:në të gjitha analizat bakteriologjike që nuk I janë përgjigjur standardeve të ujit të pijes ka rezultuar klori residual në sasi prej 0.2-0.3 mg/l.

Sa I përket analizave Bakteriologjike në Njësitë Dragash,Malishevë dhe Suharekë janë të kënaqshme.

Analizat Fiziko-kimike në të gjitha Njësitë ka qenë me parametra që I përgjigjen standardeve të ujit të pijes.

Raport nga Menaxheri i projekteve

Projekti : Programi Mbështetës për ujë dhe Kanalizim ne zonat Rurale Faza e V-te

Investues : Qeveria Zvicerane dhe Qeveria e Kosovës

Implementues: Dorsch Gruppe (Dorsch International Consultants) nga Gjermania dhe CDI(Community development initiatives) nga kososva (Ekipi I stafit Nderkombetar dhe Vendor)

Vlera e përgjithshme e investimeve 14,000.000. Euro , për shtat Kopanit Rajonale te Kosovës .

Qëllimi : Shërbimet publike te Kosovës te mbulojnë me furnizim te ujit te pijshëm pjesën me te madhe te popullsisë ne tere vendin dhe te menaxhoi sistemin e trajtimit te ujërave te zeza ne pilot projektet .

Takimi i pare i grupit punues 04 Mars 2014 , Zyret e Hidroregjionit Jugor Prizren

Ne kete takim kanë marr pjese Kryetaret e Kuvendeve Komunale (Prizreni,Suhareka, Dragashi, Malisheva ,Mamusha) ,Hidroregjioni jugor. Ne takim u prezantua Program Mbështetës për ujë dhe Kanalizim ne zonat Rurale ne Kososve -RWSSP-Faza e V-te

>Programi do te ket disa komponentete :

Komponente e pare - perfitues do te jene fshatrat qe nuk kan fare sitem te ujesjellsit

Komponente e dyte – Fshaterat qe kan sitem te ujesjellsit por kan nevoj te rehabilitoren per te qene plotesisht funksional.

Komponente e trete-Ndertimi i impianteve biologjik per trajtimin e ujrave te zeza ne zonat rurale- pilot projekte

Komponente e Katerte - Zona e pare mbrojtese e burimeve ujore

>Caktimi I Anetareve te Grupit punues

Implementuesit e programit kerkue qe te caktohen nga nje anetar i Kuvendeve Komunal edhe Hidroregjioni Jugor me kompetenca te plota per te marr pjes ne grupin e punes .

Programi Mbeshtetes per Uje dhe Kanalizim ne Zonat Rurale ne Kososve -Faza e V-te do te jete kater vjeqar.

ME ,24 Mars 2014 Takimi I dyte , Zyret e Hidroregjionet Jurgo

Agjenda ,

-Prezentimet e projekt perpozimeve nga Komuna e Prizrenit ,Suharekes Malisheves ,Mamushes dhe Dragashit

Anetaret e Grupit punues;

1/ Zenel Zenelaj nga Hidroregjioni Jugor

2/ Florim Krasniqi , Drejtor i Urbanizmit - K.K. Dragash

3/ Nexhat Ramadani , Drejtor i Sherbimeve Publike - K.K. Suhareke

4/Urime Kastrati ,Drejtor i Urbanizmit - K. K. Malisheve

5/ K.K. Prizrenit

6/K.K.Mamushes

Ne kete taim u diskutuan fshatrat te cilat nuk kan fare ujesjelles dhe jene ne prioritet dhe njeherit jene mundesit reale per furnizim me uje , por u mungon sistemi i ujesjellesit.

Kuvendi Komunal i Prizrenit dhe Mamushes nuk kan perzgjedh anetarin e Grupit punues .

Ne takimet e radhes me prioritete eshte komponente e pare -Fshatrat qe skan fare sitem te ujesjellsit.

Detyra ne vijim e grupit punues me implementuesit e projeketit eshte pergaditen projeketet ideore per fshatrat te cilat do te jene ne listene e perpozuar per investime .

Faza e pre e aplikimit mbyllet ne gusht

Takimet vazhdojn sipas nevojjes .

Aktivitetet mujor - Njësia Prizren / TM-1, 2014

*Furnizimi me ujë ka qenë i rregullt në përgjithësi, përveç në disa raste kur ka pas ndërhyrje në mirëmbajtje në rrjet të ujësjellësit dhe gjatë punimeve për pastrimin e ujëmatësve zonal.

*Operacionet e mirëmbajtjes së ujësjellësit dhe të kanalizimit janë: Në rrjetin e ujësjellësit 221 aktivitete, ndërsa në rrjetin e kanalizimit 109 raste në total me 330 intervenime në të dy rrjetet.

*Trajtimi dhe klorifikimi: Këto veprime bëhen për çdo ditë, si dhe marrje e analizave të ujit nga e kompania jon dhe Instituti i Shëndetit Publik.

*Shërbimi i përpunimit dhe kontrollit të kualitetit të ujit - Përcjellja permanente e procesit të klorifikimit në qytete dhe regjion, mostrat e marruara Fiziko-Kimike dhe Bakteriologjike.

*Gjatë muajit TM-1 vitit 2014 kanë vazhduar me punimet tek 40 puset ku është përfunduar kanali si dhe pjesa dërmuese e murit mbrojtës. Ka filluar rregullimi dhe rrafshimi i terenit ku dheu i tepërt është bartur në pjesët e hapura të kanalit, vendosjen e pompave tek puset 1 dhe 2, janë bërë planifikimet e pjesëve fazonike dhe me prerjen e gypit të çelikut janë vendosur pompat.

*Gjatë TM-1 / 2014 furnizimi me ujë ka qenë i rregullt 24 orë duke iu falënderuar aktiviteteve me rastin e shpimeve të puseve në lokacionin e Bunarit II ku edhe pse kemi rënje nga prurjeve natyrore kemi arritur me

i zëvendësuar për 120 l/s dhe e kemi rikthyer furnizimin në lagjen Tususit në gjendje të rregullt 24 orë me ujë.

*Me TM-1 është betonuar bazamenti për vendosjen e pompës tek puseve të pavarësisë.

*Gjatë Shkurtit është vendosur pompa 18.5 kw, është bere demontimi i pompes 11.5 kw dhe montimi i pompes 9.2 kw, montimi i pompes 7.5 kw në galeri.

*Shpimin e dy puseve tek livadhi ku kanë rezultuar të suksesshëm.

*Gjatë TM-1 i kemi vendosur dy pompa zhytëse 9.2 kw dhe e kemi kompenzuar ujin i cili ka rënie tek kaptazha e katërt.

*Per momentin për të evituar krizën e ujit, në qytet gjatë natës jemi duke bërë reduktime në lagjen “Bajram Curr”.

*Në bashkëpunim me komunën është bërë ndërrimi i gypit Ø 90 azbest cemento ne gyp polietilen tek lokacioni i rrugës Xhevat Berisha ku është përmirësuar furnizimin me ujë të pijes.

*Në TM-1 është bërë pastrimi i filterit te zona e Ralinit, problemet për furnizim që janë paraqitur në rrugën Nena Terez, rruget Tefik Qanga , rr.Preveza dhe rr. Sangjakut.

*Problemet me te cilat ballafaqohemi per momentin jan Lagjja Dardania nje pjes e kurriles, nje pjes e rruges Aleks Buda gypi Ø80 tek rrethi në Bazhdarane.

*Ne kordinim me Komunen dhe ne Financim te plot nga ana e Komunes ka vazhduar projekti i kaptazhes se re ku pritet te perfundoj ka fundi i muajit Tetor.

*Ne kordinim me Komunen dhe komunitetin jan berë disa projekte lidhur me zavendesimin e gypave transportues ku si shkak kryesorë janë gypat e vjeter dhe në persipër e kemi marrë gropimin dhe qeshtjet teknike kurse furnizimin me gypa dhe rregullimin e rruges e kan marr pergjegjesin komuna dhe komuniteti.

Aktivitetet mujor - Njësia Malishevë – TM-1, 2014

*Gjatë TM-1 /2014 prodhimi i ujit ka qenë pothuajse i njëjtë me tremujorin paraprak.

*Në TM-1 , kemi rritje të prodhimit të ujit nga viti paraprakë të TM-1 2013 në rritje prej 13.211 m³ ose 4.08%.

*Furnizimi me ujë me ujë gjatë TM-1 2014 , ka qenë i mirë dhe pa reduktime, me përjashtim të fshatit Lladrofc ku si pasojë e mungesës së ujit, furnizimi me ujë ka qenë i vështirësuar dhe me ndërprerje në shumë zona të fshatit, ndërsa në pikat më të larta, nuk ka pasur fare furnizim me ujë.

*Në fshatin Kervasari , pompa e ujit 11.5 kw është djegur dhe konsumatorët kanë ngelur pa ujë për 48 orë deri sa është riparuar pompa , ndërsa në Crrallukë kemi hasur shume konsumator duke i mbushur pusët e tyre mbi fshat me ujin e ujësjellësit ,ku pastaj me gravitet janë furnizuar me ujin tonë. Për këtë arsye kemi marrë vendim për të ju ndaluar ujin për 48 orë me qëllim identifikimin e puseve .Ne i kemi njoftuar Kryetarin e KK-Malishevë , kryetarin e fshatit Carrallukë dhe zëdhënësen e kompanisë.

*Analizat e ujit – Gjatë muajit TM-1 janë realizuar mostra të analizave bakteriologjike dhe mostra të analizave fiziko-kimike dhe sipas rezultateve të gjitha iu kanë përgjigjur standardeve.

*Aktivitete lobimi Kontaktet me Kryetarin e KK. Malishevë për çështje me interes të Njësisë.

Kontakte me kryetarët e 6 fshatrave që kanë ujësjellës për ti marrë në menaxhim.

*Rregullimi i defekteve – Rrjeti primar 35 defekte, Rrjeti sekondar 44 defekte, Debllokimi i kanalizimeve 6 ndërhyrje dhe 1.8 km kanal të pastruar, Defekte në Stacionet e pompimit , në kervasari(djegëja e pompës 11.5 kw), Riparimi i pompës në st. pompues në kervasari, Ankesat teknike -7, Ankesat komerciale -1, Njoftime për shkyçje-60, shkyçje për mospagesë -31, Kyçje ilegale - 21, Shkyçje të kyçjeve ilegale -21, Rikyqje -39, Kyçje të reja –131, (Amvisëri -115, Lokale -11, industri -5), Verifikim të ujëmatësve -812, Inkasimi nga kontrolla – 8159.20 €, Ujëmatës të ndërruar - 25, Ujëmatës të montuar-79.

Aktivite e mujore Njësia Suharekë, TM-1 / 2014

*Furnizimi me ujë gjatë këtij tre mujori ka qenë kryesisht i mirë dhe pa reduktime, me përjashtim të fshatit Dobërdelan, ku sasia e ujit që është prodhuar, nuk ka qenë e mjaftueshme për tërë fshatin. Kjo situatë tani më është tejkaluar dhe kemi furnizim të pandërprerë.

*Probleme më të vogla me furnizim me ujë ka pasur edhe në fshatin Studenqan për shkak të thatësisë ku kemi pasur rënie të vazhdueshme të sasisë së ujit, mirëpo edhe këtu kemi intervenuar dhe kemi shtuar sasinë e ujit, por mbetet të ndërtohet kaptazha e re dhe të stabilizohet furnizimi.

*Edhe më tutje kemi furnizim jo adekuat në periferi të qytetit të Suharekës dhe atë për shkak të nivelit të ultë të bazenit në Shirokë, prej nga furnizohet qyteti dhe si pasojë kemi shtypje të ultë, ndërsa në pikat më të larta fare nuk ka furnizim.

Uji i prodhuar - Për TM-1 të vitit 2014 kemi rritje të sasisë së ujit të prodhuar për 12,465 [m³], në raport me TM-4 të vitit 2013, pra nga 503,840[m³] në TM-4 2013, është ngritur në 516,305[m³] në TM-1 2014. Kjo mund të arsyetohet rritje e këkesës për shkak të thatësisë që ka mbretëruar gjatë muajit mars.

Uji i pafaturuar - Edhe uji i pafaturuar në TM-1 2014 ka shënuar rritje për 19,070 [m³], pra nga 312,354 [m³] në TM4 2013, në 331,424 [m³] në TM1 2014, ose për 6.1[%]. Edhe përkundër masave të vazhdueshme të shërbimit teknik në mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjellësit, raportet tregojnë se uji i pafaturuar mbetet në kuotën mbi 60[%], që do të thotë se është një problem i vazhdueshëm në shoqërinë tonë, i cili kërkon një trajtim të veçantë.

Analizat e ujit – TM1 2014 - jatë TM1 2014 janë realizuar 43 mostra të analizave bakteriologjike, prej tyre 40 iu kanë përgjigjur standardeve, ndërsa tri prej tyre jo.

Rregullimi i defekteve – TM1 2014: Rrjeti primar 1 defekt, Rrjeti sekondar 87 defekte, Zëvendësimi i ujëmatësve dhe xhamave 5 raste, Debllokimi i kanalizimeve 14 ndërhyrje, Stacionet e pompimit 13 defekte Realizimi i lidhjes së rrjetit shpërndarës të ujësjellësit në fshatrat Reshtan- Studenqan me gjatësi L = 250 [m] me gyp DN-63 [mm]-Për shkak të mungesës së mjaftueshme të sasisë së ujit në fshatin Studenqan, si pasojë e thatësisë, është realizuar kjo lidhje fizike me rrjetin e fshatit Reshtan si zgjidhje emergjente edhe pse teknikisht nuk është sipas standardeve sepse gypi që i bashkon dy rrjetet është i ngushtë me diameter DN-63 [mm] PE, por e kemi shfrytëzuar distancën minimale në mes dy rrjeteve prej 250 [m].

Realizimi i lidhjes së gypit DN-315 [mm] PE nga Rezervuari i ri me gypin kryesor ekzistues DN-450[mm]PE në Gelancë-Është pregaditur vendi, është bërë shpimi i rrugës, janë lidhur pjesët fazonike si dhe është ndërtuar puseta kontrolluese prej betoni.

Vazhdimi i punimeve në ndërtimin e Rezervuarit V= 2 × 1500 m³-Lidhja e gjashtë puseve me Rezervuarin,Gjatë muajit janar është hap kanali përgjatë vijës së puseve, janë vendosur gypat e ujit me dimensione sipas sasisë së ujit të secilit pus deri në hyrje kryesore në Rezervuar, e poashtu edhe rrjeti elektrik është instaluar i veçantë për secilën pompë dhe vazhdon deri te komanda kryesore e cila do të jetë në objektin përcjellës të Rezervuarit.

Punët konkrete ndërtimore sipas raportit të mbikqyrësit:

*Betonimi i pllakës së poshtme të komorës shkarkuese të ujit nga beton-armeja me trashësi t= 25cm ,marka MB=30 me aditivë dhe vëllim V= 3.5 m³.

*Vibrimi i pllakës së poshtme të komorës shkarkuese me gjilpërë sferike, (5cm diametri).

*Betonimi i murit rrethues të dhomës komanduese mbi fazoneri, nga beton-armeja, marka MB=30 me aditivë dhe vëllim V= 1.5 m³.

*Vibrimi i murit rrethues të dhomës komanduese mbi fazoneri me gjilpërë sferike, (5cm diametri).

*Betonimi i mureve të komorës shkarkuese, marka MB=30 , vëllimi V=5 m³.

*Vibrimi i mureve të komorës shkarkuese me gjilpërë sferike, (5 cm diametri).

Punët e realizuara:

*Punët e latimit në muret e komorës shkarkuese të ujit .

*Prerja, lakimi dhe punimi i hekurit për muret e komorës shkarkuese të ujit.

*Punët e latimit në murin e dhomës komanduese të ujit.

*Prerja , lakimi dhe punimi i hekurit për murin e dhomës komanduese të ujit.

*Mbyllja e tapave nëpër murin e rezervoarit të parë, me material” DW URBAN 40” nga prodhuesi DAST.

*Montimi i fazonerive në komorën shkarkuese të ujit, sasia 1 FF - DN 200 mm, 3 FF – DN 80 mm, 3 FF - DN 65 mm, 6 FF – DN 50 mm.

Lyerja e mureve të brendshme në rezervoarin e parë me llaq hidroizolues një komponentësh me bazë qimentoje “monolit” nga prodhuesi DAST, shtresa e parë e hidroizolimit në rezervoar.

*Montimi i pompave në Stacionin e ri të pompave “Krismat e Sali Shabanit” Sipas sasisë së ujit që kanë, në gjashtë puse janë montuar pompat me të gjitha pjesët përcjellëse dhe me fuqi adekuate nga 5,5 [kw] – 18,5 [kw].

*Vazhdimi i punimeve në ndërtimin e Rezervuarit $V= 2 \times 1500 \text{ m}^3$ -Testimi i Rezervuarit dhe gypit DN 315[mm]PE të ujësjellësit nga Rezervuari deri në Gelancë. Është bërë mbushja e njërës pjesë të Rezervuarit me vëllim $V= 1500 \text{ m}^3$ me ujë nga dy puse dhe është testuar për 48 orë. Është konstatuar çdo gjë është në rregull për këtë pjesë të rezervuarit, nuk ka rrjedhje, prandaj kanë vazhduar punimet në izolimin dhe mbushjen e hapsirës nga ana e jashtme.

Gjithashtu është bërë edhe testimi i gypit DN 315[mm]PE, nga rezervuari deri në Gelancë, duke vazhduar pjesë-pjesë.

*Deri në pjesën e fundit 1500m afër lidhjes kryesore në Gelancë, testimi është përfunduar dhe çdo gjë ka qenë në rregull, mirëpo për shkak se shtypja në atë pikë ka arritë në vlerën 10bar, nuk kemi mundur të vazhdojmë më tutje derisa të vendoset një barometer në kyçjen kryesore dhe mandej të testohet edhe pjesa e mbetur.

Vërejtje:Edhe në bazë të kuotave të terrenit, por edhe në bazë të rezultateve të matjeve gjatë testimit të gypit, vërehet se presioni në pjesën e fundit të gypit, e kalon vlerën prej 10[bar], derisa sipas atestit gypat e kanë shtypjen e lejuar deri në 10[bar], prandaj mendojmë se duhet të bëhet një komorë shkarkuese në një pozitë të përshtatshme, në mënyrë që presioni të jetë i përballueshëm për rrjet dhe i mjaftueshëm që t'a mbuloj tërë zonën e shërbimit.

Bashkëpunimi me Komunën e Suharekës

*Kemi realizuar një marrëveshje bashkëpunimi për furnizimin me ujë të fshatit Doberdelan si bashkëfinancim në vlerë prej 13,785.81 Euro, prej të cilave Komuna i detyrohet Kompanisë tonë me shumën prej 10,000.00 Eurove.

*Me kërkesën tonë, Kryetari i Komunës ka dhënë si donacion një pompë uji me fuqi 37[kw] me të gjitha paisjet përcjellëse, duke përfshirë gypat metalik, pjesët fazonike dhe tabelën komanduese të rrymës elektrike, ashtu siç ka qenë e montuar nga KFOR-i në kampin Kazablanka në Shirokë.

*Kjo pompë është paraparë të montohet në stacionin e pompave te “Pusi Atit”e cila do të shërbej për furnizim më të mirë me ujë të qytetarëve gjatë sezonit veror.

*Kemi arritur një marrëveshje në parim që intervenimet në rrugë të ndryshme që i bënë Njësia jonë me qëllim të rregullimit të defekteve, e ku shpesh dëmtohet asfalti, shtrimin e asfaltit e ka marrë përsipër Komuna pa kompensim nga ana jonë.

Kjo marrëveshje pritet të nëshkruhet së shpejti.

*Kemi marrë një pëqim nga Kryetari i Komunës për hulumtim dhe shtim të sasisë së ujit në fshatin Peqan dhe poashtu një kërkesë me shumë nënshkrime të qytetarëve dhe të Kryesisë së këtij fshati për t'a marrë nën menagjim sistemin e ujësjellësit.Ky fshat, sipas regjistrimit të fundit të popullsisë ka 2153 banorë.

*Jemi në koordinim me Drejtorinë e shërbimeve publike për të investuar në ndërtimin e Kaptazhës në fshatin Studenqan.

Aktivitetet mujor - Njesia Dragash –TM-1, 2014

*Aktivitetet: Furnizimi me ujë ka qenë i rregullt në përgjithësi, këtë situatë stabile e kanë mundësuar aktivitetet të cilat kanë ndodhë gjatë këtij muaji, fillimisht me sigurimin e mjaftueshëm të ujit për trajtim, pastrimin e pusetave dhe punë tjera në kaptazhë në fshatin Radesh.

*Trajtimi i ujit (sendimentimi, kaugulimi, filtrimi dhe klorizimi) është bërë në vazhdimësi.

*Aktivitete nga ekipi teknik në operativë janë bërë këto: 16.raste në sanimin e rrjetit të Ujësjellsit, ndrrime të ujëmatsave (3/4),.montime të ujëmatsave, pastrime dhe kontrollime të ujëmatsave, deblokim dhe pastrim në rrjetin e kanalizimit, si dhe angazhime tjera të ekipit teknik.

*Punët në administratë janë të azhuruara sipas rregullave që i aplikon Kompania duke i përfshirë punët nga lëmia e financave dhe atyre të administratë së përgjithëshme.

*Prodhimi i ujit: Në këtë muaj janë prodhuar 31.020.m3. ujë dhe kjo sasi ka kushtëzuar furnizim të rregullt për të gjithë konsumatorët.

*Humbjet e ujit: Prodhimi i ujit ka pasur rënje sepse vazhdimisht në tremujorin e katërt ka kërkesa më të mëdha për shfrytëzim të ujit sepse një numër i konsiderueshëm i konsumatorëve vijnë për festat e fundvitit me qka dhe rriten nevojat për shfrytëzim të ujit.

*Faturimi ka qenë më i ulët se në tremujorin e katërt sepse faturimi është në lidhshmëri me prodhimin e ujit.

*Inkasimi ka pasur rënje sepse në tremujorin e katërt janë bërë pagesa paraprakisht nga institucionit për arsye të mjeteve financiare që i kanë pasur në dispozicion

*Numri i konsumatorëve është rritur për 230 konsumator të ri sepse është marrë në menaxhim **fshati Brezne**.

*Shpenzimet në tremujor janë rritur në krahasim me vitin e kaluar sepse ka pasur aktivitete të shtuara gjatë marrjes në menaxhim të fshatit Brezne.

*Uji i pafaturuar ka qenë përafërsisht i njëjtë me vitin e kaluar ku si shkaktar i humbjeve të ujit është një pjesë e rrjetit të stërvjetruar të ujësjellsit.

*Mbulimi operativ ka pasur rënie sepse në këtë kanë ndikuar pagesa paraprake e institucioneve si dhe shpenzimet e krijuara në tremujorin e parë gjatë aktiviteteve të marrjes në menaxhim të fshatit Brezne.

III. RAPORT I SHËRBIMIT RAJONAL PËR KONSUMATORË

3.1 Aktivitetet

- Në fund të muajit mars (TM1 2014) në nivel rajonal janë shtyp dhe shpërnda te konsumatorët 39.624 fatura, prej tyre: 34.290 amvisëri , 4.715 biznese dhe 619 institucione. Në këtë tremujor në krahasim me TM4 2013 kemi 746 fatura të lëshuara me tepër. Një numër i këtyre konsumatorëve është si rezultat i pëlqimeve për kyçje (179 konsumatorë), marrja ne menaxhim e fshatit Brezne në Dragash (230 konsumatorë) ndërsa pjesa tjetër është rezultat i identifikimit dhe legalizimit të konsumatorëve ilegal nga ekipet e kontrollës (337 konsumatorë). Sipas njësive kemi këtë rritje të konsumatorëve në krahasim me tremujorin paraprak :
Prizren: +220 , Suharekë: +165, Malishevë: + 131 dhe Dragashi + 230.

NUMRI I FATURAVE TË LËSHUARA

JANAR - MARS 2014

K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A - PRIZREN

2014					
No.	Të dhënat	JANAR	SHKURT	MARS	JANAR-MARS 2014
1	Shtëpiak	33,770	33,891	34,292	34,292
2	Ndryshimi		121	401	522
3	Ndryshi. %		0.4	1.2	1.5%
4	Kome.-Indu.	4,640	4,669	4,715	4,715
5	Ndryshimi		29	46	75
6	Ndryshi. %		0.6	1.0	1.6%
7	Institucional	619	618	619	619
8	Ndryshimi		(1)	1	-
9	Ndryshi. %		(0.2)	0.2	0.0%
10	TOTAL	39,029	39,178	39,626	39,626
11	Ndryshimi		149	448	597
12	Ndryshi. %		0.4%	1.1%	1.53%

- Gjatë këtij tremujori janë faturuar 1.658.146 m³ ujë të ndarë në këto kategori: amvisëri: 1.371.965m³, biznese: 106.597 m³ dhe institucione 179.854 m³ ujë. Nëse e krahasojmë me tremujorin paraprak kemi një faturim më të vogël prej 117.687 m³. Ndërsa sipas njësive operative në krahasim me tremujorin paraprak kemi këtë gjendje: Prizreni - 139.275 m³, Suhareka - 6.605 m³, Malisheva +33.828 m³, Dragash -5,635 m³.
- Nëse krahasohet TM4 2013 me TM1 2014, kemi një rënie të faturimit prej 117.687 m³ ujë në nivel . Rëniet në faturim shihen në secilën njësi, përveç njësisë së Malishevës, e cila ka rritje në faturim në krahasim me TM4 2013. Arsytet për rënie të faturimit janë dhënë te secila njësi operative veç e veç, mirëpo si arsye kryesore është faturimi i rritur i disa institucioneve në TM4 2014 për arsye të parapagimit të shpenzimeve të ujit (kryesisht shkollat në Prizren). Arsye tjetër është rritja e numrit të konsumatorëve të cilët kanë vendos ujëmatës (tani shpenzimet kanë rënë pasi faturimi paushall te këta konsumatorë ka qenë dy herë më i madh).Në muajt në vazhdim pritet rritje e konsumit të ujit.

FATURIMI- m3
JANAR - MARS 2014

K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A - PRIZREN

2014					
No.	Të dhënat	JANAR	SHKURT	MARS	JANAR-MARS
1	Shtëpiak	8,217	7,513	9,332	25,062
2	Ndryshimi		(704)	1,819	
3	Ndry. %		(8.6)	24.2	
4	Kome.-Indu.	578	555	495	1,628
5	Ndryshimi		(23)	(60)	
6	Ndry. %		(4.0)	(10.8)	
7	Institucional	6,905	7,120	7,105	21,130
8	Ndryshimi		215	(15)	
9	Ndry. %		3.1	(0.2)	
10	TOTAL	15,700	15,188	16,932	47,820
11	Ndryshimi		(512)	1,744	
12	Ndry. %		(3.3)	11.5	

Arsyetim:

- Në të tri njësit operative kemi rënie të faturimit në krahasim me tremujorin paraprak si rezultat i rënies së konsumit të ujit si konsum sezonal, ndërsa në Malisheve kemi rritje të faturimit si rezultat i identifikimit të disa lidhjeve ilegale dhe ngarkesës me paushall për periudhën e kaluar .
- Përcjellja dhe kontrolli i punëve të inkasimit, kontrollës dhe shkyçjes në kuadër të KRU „Hidroregjioni Jugor“ sh.a., në bashkëpunim me udhëheqësit e njërive. Gjatë këtij muaji në nivel rajonal nga ekipet e kontrollës janë vizitu 3,695 konsumatorë, janë legalizuar dhe regjistruar 507 konsumatorë të cilët bazuar në procedurat e brendshme ndërsa janë shkoq 57 konsumatorë për lidhje ilegale dhe mospagesë .Konsumatorët të cilët janë hasur me lidhje ilegale janë shkyç menjëherë, dhe janë me një paushall për periudhën e kaluar që e kanë keqpërdor ujin .Nga këto ekipe në nivel rajonal janë inkasuar 49,781.31, euro nga konsumatorët që kanë borxh mbi 400 euro .
- Në nivel rajonal janë pranuar 325 ankesa/kërkesa të konsumatorëve prej tyre:
 1. 183 ankesa/kërkesa teknike- detektive, mungesë të ujit, rrjedhje të ujit

2. 142 ankesa/kërkesa komerciale- ankesa rreth faturimit paushall të rritur, kontestim i faturave, faturim i dyfishtë etj

- Vazhdim i aksionit për njoftime për shkycje duke ndërruar terrenet te konsumatorët që:
 - Nuk i janë përgjigjur pagesave në dy muajt e fundit
 - Kanë borxhe mbi 400 euro dhe nuk i përgjigjen pagesës dhe ri programimit të borxhit. Janë ndërruar terrenet e inkasantëve në mënyrë që të përfshihen numër më i madh i konsumatorëve.
 - Kontrollë rreth eliminimit te keqpërdorimeve te ujit si :
- Pjesëmarrje në takimet mujore në Komisionet Këshilluese të Konsumatorëve, ku pjesëmarrës në këto takime janë zyrtar nga ZRRUK dhe përfaqësues nga Kuvendet Komunale të zonës së operimit të KRU „Hidroregjioni Jugor“sh.a.

Raport I ekipes së Kontrollës dhe shkycjes

Nr.	Njesia Operative	Lidhjet e reja	Shkycjet	Lidhje ilegale	Verifikimi i ujëmatësve	Inkasimi nga Kontro.
1	Prizren	266	3	3	1915	32,463.11 €
2	Suharekë	110	23	17	950	9,159.00 €
3	Malishevë	131	31	21	812	8,159.20 €
4	Dragash	0	0	0	18	0.00 €
5	KRU "Hidroregjioni Jugor"	507	57	41	3695	49,781.31 €

Raport I ankesave TM1 - 2014

MUAJI	JANAR	SHKURT	MARS	TOTAL
ANK. TEKNIKE	76	55	52	183
TË SHQ.	76	55	50	181
ANK. KOMER.	47	40	55	142
TË SHQ.	47	40	52	139
TOTAL	123	95	107	325

3.2 Raport e medieve

JANAR 2014

Nr	DATA	MEDIAT	PËRSHKRIMI
1	01.01.2014	RTK	PRONONCIM RRETH TRAJTIMIT TË UJËRAVE TË ZEZA
2	08.01.2014	LAJM	PUBLIKIM I TARIFAVE
3	08.01.2014	www.tv-opinion.com	SHTRENJTOHET UJI NË PRIZREN
4	08.01.2014	www.indeksonline.net	SHTRENJTOHET UJI NË GJAKOVË E PRIZREN
5	09.01.2014	LAJM	SHTRENJOHET UJI NË GJAKOVË E PRIZREN
6	09.01.2014	KOSOVA SOT	CAKTOHEN TARIFAT PËR VITIN 2014
7	09.01.2014	KOHA DITORE	NGRIHET ÇMIMI I UJIT PËR KONSUMATORËT E PRIZRENIT E TË GJAKOVËS
8	09.01.2014	TV-OPINION	EMISION I DREJTPËRDREJTË I MËNGJESIT(UJËRAT E ZEZA)
9	16.01.2014	TV-PRIZRENI	PRONONCIM LIDHUR ME FURNIZIMIN E LAGJES KURILLË
10	19.01.2014	www.rtklive.com	RRITEN TARIFAT E UJIT NË PRIZREN
11	19.01.2014	www.prizrenpress.com	PRIZRENASIT TË MLEFOSUR ME RRITJEN E ÇMIMIT TË UJIT TË PIJES
12	23.01.2014	TV-OPINION	EMISION I DREJTPËRDREJTË I MËNGJESIT(AKTIVITETET E KOMPANISË)
13	26.01.2014	KLAN KOSOVA	PRONONCIM- NJËSIA SUHAREKË
14	27.01.2014	TV-BESA	TAKIM ME POLICIN DHE INSPEKTORATIN,SI DHE BANORËT E LAGJES KURILLË
15	27.01.2014	TV-OPINION	TAKIM ME POLICIN, INSPEKTORATIN DHE BANORËT E LAGJES KURILLË
16	27.01.2014	www.tv-opinion.com	POLICIA E INSPEKTORATI NË NDIHMË TË KOMPANISË "HIDROREGJIONI JUGOR" NË PARANDALIMIN E KEQPËRDORIMIT TË UJIT
17	30.01.2014	KOHA DITORE	DEPUTETËT NDËRMJETËSOJNË ME BANORËT PËR SHLYERJEN E BORXHEVE
18	30.01.2014	TV-OPINION	EMISION I DREJTPËRDREJTË I MËNGJESIT(AKTIVITETET E KOMPANISË)

SHKURT 2014

Nr.	DATA	MEDIAT	PËRSHKRIMI
1	02.02.2014	ZËRI	ARTIKULLI: PRIZRENASIT 8 MILIONË EURO BORXH UJËSJELLËSIT
2	02.02.2014	www.gazetaeprizrenit.com	ARTIKULLI: PRIZRENASIT 8 MILIONË EURO BORXH UJËSJELLËSIT
3	02.02.2014	www.zëri.info	ARTIKULLI: PRIZRENASIT 8 MILIONË EURO BORXH UJËSJELLËSIT
4	03.02.2014	www.tv-opinion.com	ARTIKULLI: PRIZRENASIT 8 MILIONË EURO BORXH UJËSJELLËSIT
5	03.02.2014	www.prizrenpress.com	ARTIKULLI: PRIZRENASIT 8 MILIONË EURO BORXH UJËSJELLËSIT
6	05.02.2014	TV-BESA	PRONONCIM: AKTIVITETET E KOMPANISË
7	07.02.2014	KOSOVA SOT	ARTIKULLI:PRIZRENI NUK KA TELASHE ME FURNIZIM ME UJË
8	14.02.2014	MJETET E INFORMIMIT PRIZREN	NJOFTIM: MUNGESË E UJIT, PËR SHKAK TË NDËRPRERJEVE TË RRYMËS
9	19.02.2014	MJETET E INFORMIMIT PRIZREN	NJOFTIM: NDËRPRERJE E FURNIZIMIT PËR SHKAK TË PUNIMEVE TE 40 BURIMET
10	20.02.2014	MJETET E INFORMIMIT PRIZREN	NJOFTIM: NDËRPRERJE E FURNIZIMIT PËR SHKAK TË DEFEKTIT (NJËSIA SUHAREKË)
11	25.02.2014	www.prizrenpress.com	ARTIKULLI: PADITEN KEQPËRDORUESIT E UJIT NË PRIZREN
12	25.02.2014	www.rtklive.com	ARTIKULLI:PADITEN KEQPËRDORUESIT E UJIT NË PRIZREN
13	25.02.2014	www.tv-opinion.com	ARTIKULLI: PADITEN KEQPËRDORUESIT E UJIT NË PRIZREN
14	28.02.2014	MJETET E INFORMIMIT PRIZREN	NJOFTIM: NJËSIA MALISHEVË, NDËRPRERJE E UJIT NË CARALLUKË
15	28.02.2004	TV-OPINION	LIGJËRATË E MBAJTUR PARA NXËNËSVE, PËR TRAJTIMIN E UJËRAVE TË ZEZA
16	28.02.2014	TV-PRIZRENI	PREZANTIM PËR TRAJTIMIN E UJËRAVE TË ZEZA

MARS 2014

Nr	DATA	MEDIAT	PËRSHKRIMI
1	01.03.2014	MJETET E INFORMIMIT PRIZREN	NJOFTIM: NDËRPRERJE E UJIT PËR SHKAK TË DEFEKTIT ,TË SHKAKTUAR NGA NJË KOMPANI PRIVATE
2	04.03.2014	TV-BESA	PRONONCIM - HAPJA E PUSEVE TË REJA TE 40 BURIMET
3	05.03.2014	KOSOVA SOT	ARTIKULLI: PRIZREN, PLUS 100 LITRA UJË NË SEKONDË
4	11.03.2014	www.prizrenpress.com	SHTATËQIND MIJË EURO PËR UJËMBLEDHËSIN E SENIKUT TË MALISHEVËS
5	12.03.2014	ZËRI	ARTIKULLI: HAPJA E PUSEVE TË UJIT, SHPËTIMI I PRIZRENIT NGA THATËSIA
6	12.03.2014	www.zëri.info	ARTIKULLI: HAPJA E PUSEVE TË UJIT, SHPËTIMI I PRIZRENIT NGA THATËSIA
7	13.03.2014	KOHA DITORE	ARTIKULLI:700 MIJË EURO PËR REZERVUARIN E UJIT NË SENIK
8	13.03.2014	ZËRI	ARTIKULLI: 700 MIJË EURO PËR UJËMBLEDHËSIN NË SENIK
9	13.03.2014	www.koha.net	ARTIKULLI: PËR REZERVUARIN E UJIT NË SENIK TË MALISHEVËS 700 MIJË EURO
10	19.03.2014	MJETET E INFORMIMIT PRIZREN	NJOFTIM: NDËRPRERJE E UJIT PËR SHKAK TË ELIMINIMIT TË DEFEKTIT
11	19.03.2014	MJETET E INFORMIMIT PRIZREN	NJOFTIM: NDËRPRERJE E UJIT, PËR SHKAK TË RIPARIMIT TË POMPËS
12	20.03.2014	MJETET E INFORMIMIT PRIZREN	NJOFTIM: NDËRPRERJE E UJIT, PËR SHKAK TË PASTRIMIT TË REZERVUARIT TË UJIT
13	20.03.2014	KOSOVA SOT	ARTIKULLI: PËR SHKAK TË RENOVIMEVE, NUK DO TË KETË UJË TË PIJSHËM
14	21.03.2014	TV-OPINION	PRONONCIM - ME RASTIN E DITËS BOTËRORE TË UJIT, SHPËRBLIMI I 10 PUNËTORËVE TË DALLUAR

3.3 Pengesat në realizimin e objektivave:

- Vështirësitë në inkasim si rezultat i mospagesës së obligimeve rrjedhëse për shërbimet e ujësjellësit :
 1. Te konsumatorët e amvisërisë- gjendja e rënde ekonomike
 2. Te bizneset – pamundësia e pagesave rrjedhëse e cila vjen nga rënia e punës në biznese.
- Rritja e numrit të konsumatorëve si raste sociale si dhe rritja e konsumatorëve që nuk kanë mundësi për ti paguar obligimet ndaj kompanisë.
- Mos furnizimi i rregullt me ujë në disa zona (reduktime) po ndikon në inkasim të shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit.

3.4 Planet për të ardhmen:

- Vazhdimësia e punës së ekipeve të kontrollit për së bashku me operativen për shkyçjen e konsumatorëve borxhlinj të mëdhenj mbi =300,00 euro, të cilët nuk bëjnë pagesa dhe riprogramim të borxhit..
- Kontaktet më të shpeshta me konsumator që kanë shuma të larta të burgjeve në mënyrë që të arrihet nënshkrimi i kontratave për ri programimin e borxhit në mënyrë që këta konsumatorë të futen në sistem të pagesave të faturave
- Konsumatorët të cilët shkyçen nga rrjeti për mos pagës nuk do të ri kyçen pa i paguar së paku 30% të borxhit total .
- Marrja e masave ligjore sipas Zyrës Rregullative për shkyçjen e konsumatorëve për mos pagesë.
- Rritja e efikasitet të ekipes së kontrollës dhe ekipës së shkyçjes.
- Pardia e konsumatorëve në gjykatë për mos pagesë.
- Limitimi apo normimi i kontrollës për mbledhjen e borxheve aty ku kanë vështirsi inkasantet.
- Angazhim i ekipes së kontrollës për 3-4 ditë në muaj nga njësia e Prizernit nga njëra njësi në tjetrën nëse kërkohet nga Njësit Operative.

IV. RAPORT I DEPARTAMENTIT ADMINISTRATIV

4.1 Aktivitetet Janar-Mars 2014

Departamenti i administratës gjatë këtij tremujori është marrë me përgatitjen e raporteve dhe informatave nga veprimtaria e shërbimit juridik, varësisht nga detyrat dhe obligimet e punës të parapara për këtë departament.

- Gjatë këtij tremujori janë përgatitur të gjitha procesverbalet dhe vendimet e dala nga Bordi i Drejtorëve, Komisioni i Auditimit, komiteti i financave, komiteti për hulumtime dhe teknologji, komiteti për staf dhe shpërblime dhe Kryeshefi Ekzekutiv.
- Janë përgatitur dhe vazhduar kontratat e punës për 2014, për të gjithë punëtorët e Kompanisë Kohëzgjatja e kontratave është bërë duke u bazuar në raportin e vlerësimit vjetor të punës së secilit punonjës.
- Shërbimi juridik ka përgatitur kontratat në mes të kompanisë dhe palëve të treta nga lamia e veprimtarisë së Kompanisë.
- Gjithashtu ky shërbim lëshon për të punësuarit të gjitha llojet e aktvendimeve, autorizimeve dhe vërtetimeve nga fusha e marrëdhënieve të punës.
- Përgatitja e Aktvendimeve për pushim pa pagesë për disa punëtor të Kompanisë pas aprovimit të kërkesës së tyre nga udhëheqësi i shërbimit përkatës.
- Përgatitja e Aktvendimeve për disa punëtor lidhur me kompensimin e punës jashtë orarit me ditë pushimi sipas Ligjit të Punës.
- Janë përgatitur Vendime për mbikëqyrje të punimeve dhe pranim teknik të punimeve për projektet e investuara me mjetet vetanake të Kompanisë dhe nga buxheti i Komunave të njësive punuese.
- Me Vendim është Emruar përfaqësuesi brenda kompanisë për mbarvajtjen e projektit "Programi mbështetës për uji dhe kanalizim në zonat rurale faza e V-të". Përfaqësuesi i Emruar nga KRU "Hidroregjioni Jugor" Sh.A do të bëjë Sigurimin e të gjitha dokumenteve të nevojshme dhe shkembimi i tyre në mes të CDI, Kuvendeve Komunale dhe institucioneve tjera të involvuara në projekt. Organizimin e vizitave në terren me qëllim të vërtetimit të informacioneve sa i përket gjendjes ekzistuese të sistemeve të ujësjellësit dhe kanalizimeve, njëherit identifikimi i pozicioneve për ndertimet e parapara në studimin e fizibilitetit.
- Është përgaditur Kontratë mbi dhenjen e shërbimit, ndërmjet K.U.R. "Hidroregjioni jugor" Sh.A dhe K.R.U. "Radoniqi" Sh.A. me seli në Gjakovë. Lënda e kësaj kontrate është riparimi dhe servisimi i ujmatësave në servis për riparim dhe servisim të ujmatësave (Bazhdarim) në Prizren, me profile të ndryshme nga ana e K.R.U. "Hidroregjioni jugor" Sh.A. si dhënësi i shërbimit. Shfrytëzuesi i shërbimit obligohet që në emër të riparimit dhe servisimit të ujmatësave të paguaj sipas Vendimit mbi caktimin e çmimorës e cila është pjesë përberse e kontratës, dhe pagesën në emër të TVSH-së.
- Janë shpërblyer për angazhim të veçant në punë, 10 (dhjetë) punëtorët e dalluar për vitin 2013 me mjete monetare në vlerë prej 100 € dhe me mirënjohje.
- Në Departament të Administratës kemi patur auditim nga Auditori i Brendshëm lidhur me ndryshimet apo rritjen e pagës bazë (koeficientëve) për punonjësit e KRU "Hidroregjioni Jugor" sh.a në Prizren, për periudhën kohore janar – dhjetor 2013.
- Në Departament të Administratës kemi patur auditim nga Auditori i Jashtëm "Kanuni i Auditorit" për vitin 2013.
- Janë përgaditur dhe shpallur në shtypinë ditorë 5 (pesë) konkurse për vendet e parapara të punës nga Menaxhmenti i Kompanisë.
- Janë bërë ndërrime në pozitat e vendeve të punës me pelqimin e punëdhënësit dhe punëmarrësit varësisht nga dinamika e punës dhe nevojat e domosdoshme të Kompanisë.

- Për shkelje të detyrave të punes është shqiptuar masa disiplinore Ulje në pozitë për punonjës të R.S të njësisë së Dragashit dhe dy Suspendime të punëtorëve në njësin e Prizrenit.
- Përgjigjje NJPMNP që nuk kemi pasur kërkesë për qasje në dokumentet publike për periudhën janar-dhjetor 2013 nga asnjë profil i aplikuesve dhe se ne të ardhmen nese paraqiten kërkesa të tilla do të trajtohen në përputhje me Ligjin Nr.03/L-215 për qasje në dokumente publike.
- Takim konsultativ-punes në NJPMNP me temë:Komunikimi në mes të NP dhe NJPMNP dhe Arkivimi i dokumentacionit të QK të vitit 2013.
- Është përgaditur Libri lidhës për Qeverisjen Korporative për vitin 2013 dhe dorëzuar në NJPMNP,përmbajtja e saj përfshinë :qertifikatën e regjistrimit të Biznesit,Vendimin mbi emrimin e Bordit,procesverbalet e mbledhjeve të Bordit për 2013,vendimet e Bordit për 2013,procesverbalet e Komisionit të Auditimit,Vendimet mbi themelimin e komitetëve tjera të Bordit ,procesverbalet e komiteteve,plan-biznesi 2013-2015 dhe raporti vjetor 2013.
- Është derguar e plotësuar në NJPMNP sipas kërkesës së tyre, lista me të dhenat për të punësuarit me aftësi të kufizuar (në Kompani rasti është Invalid I luftës së UÇK-së).Poashtu ne NJPMNP është deguar lista me nr. e të punësuarve sipas nacionaliteteve për vitin 2013.
- Nga NJPMNP jemi njoftuar që është kërkuar nga Zyra ligjore e Kryeministrit interpretimi i Vendimit mbi Kompenzimin e Bordit dhe deri në pranimin e interpretimit nga ZLK është kërkuar që asnjë komitet i përkohëshëm të mos kompenzohet.
- Kanë bërë punë praktike profesionale student të Univerzitetit të Prizrenit në fushën e Kontabilitetit, Menaxhimit të burimeve njerzore, Menaxhimit të Projektëve, në fushën e Informatikës dhe Komunikimit. Puna praktike profesionale është zhvilluar në mbikqyrje të udhëheqësit nga shërbimit përkatës.

PERSONELI – JANAR– MARS 2014

Muajt	Nr.i te punsuarve sipas muajve	Vende te plotësuar	Te larguar	Të pensionuar	Verejtje
Janar	292	1		1	1 punëtor i pensionuar dhe 1punt.ka vdekur
Shkurt	296	4		0	
Mars	302	6		0	2 punt.push.pa pages

NUMRI I PUNËTORËVE SIPAS NACIONALITETEVE - GJENDJA: MARS 2014

K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A					
Nacionaliteti	Shqiptarë	Boshnjak dhe Musliman	Romë, Ashkali dhe Egjiptas	Turq	Gjithsejtë numri i punëtorëve
Numri i Punëtorëve	249	36	6	11	302
Numri i Punëtorëve në %	82.5	11.9	2.0	3.6	100

NUMRI I PUNËTORËVE NË 1000 KONSUMATORË DHE SIPAS GJINISË

GJINIA:	NR	NR. %	Nr. Në 1000 Kon.
FEMRA:	32	10.60	
MESHKUJ:	270	89.40	
TOTAL	302		

KUALIFIKIMI I PUNËTORËVE - GJENDJA: MARS 2014

K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A								
KUALIFIKIMI								
Kualifikimi	Fakultet	Bachelor	Sk.K. e lartë	Sh. e mesme	Sh.N.E	Shkolla fillore	Pa kualifikim	Gjithsejë
Nr. i punetoreve	28	19	0	197	0	53	5	302
Kualifikimi në %	9.27	6.29	0.00	65.23	0.00	17.55	1.66	

RAPORTI I TREMUJORIT TË PARË
LIDHUR ME PUNËT E KRYERA ME GJYQËSORIN
JANAR – MARS 2014

Periudha raportuese	Padi	Përgjigje në padi	Propozim për Ekzekutim	Kallëzime Penale	Seancat përgatitore	Seancat kryesore	Seancat e shtyra	Deklarata në Prokurori	Parashtrës në Gjykata	Parashtrës në Prokurori	ANKESA në Gjykatën e Apelit të parashtrë nga Kompania	ANKESA në Gjykatën e Apelit të parashtrë nga	Përgjigje në Ankesat e Parashtrë nga në Gjykatën	Kundërshtimet nga	REVIZION	Përgjigje në Revizion	Vendimet e Revizionit	TOTALI	Totali i lëndëve të ardhura nga Gjykatat
JANAR	/	/	1	/	1	4	1	/	3	/	/	/	/	/	/	/	/	9	10
SHKURT	3	1	6	/	1	4	1	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/	16	8
MARS	/	/	4	2	1	2	3	1	1	2	2	/	/	2	/	/	/	22	12
Totali	3	1	11	2	3	10	5	1	4	2	2	/	/	2		/	/	46	30

PARASHTRESA

Është bërë 1 (një) parashtresë për KK Prizren lidhur me interesimin tonë se në pronësi të kujt janë 2 (dy) galeri afër objektit të Kompanisë, pasi që këto galeri kanë qenë në shfrytëzim të ish ndërmarrjes "Cvileni".

Është bërë parashtresë në Policinë e Kosovës me kërkesën për vendin rreth objektit të vjetër në qendër të qytetit për ndalimin e qarkullimit dhe parkimit të mjeteve motorike në atë vend pasi që lehtë mundet me pësuar uji i pijes me ndotje nga automjetet që qarkullojnë dhe parkohen në atë hapësirë. Poashtu e njehta parashtresë është bërë edhe në Inspektoratet Komunale të KK Prizren

Është bërë Parashtresë lidhur me lëndën **C.Nr. 199/2012**, ku e kemi njoftuar Gjykatën Themelore në Prizren se pas pagesës së dëmit të shkaktuar ndaj Kompanisë sonë nga i ati i të Pandehurit Arsim Krasniqi, ne nuk jemi të interesuar për ndjekje të mëtutjeshme.

Është përkthyer Përgjigjia ndaj një ish punonjësi të Kompanisë i nacionalitetit Serb, lidhur me Kërkesën e të njëjtit për blerjen e banesës të cilën e kishte pasur në shfrytëzim nga Kompania jonë, dhe të njëjtën e kemi dorëzuar në Postë.

Pranë Gjykatës Themelore Dega në Suharekë me Parashtresë kemi kërkuar informatë se përse ende nuk është ekzekutuar lënda **CP.nr.11/13**, ku kemi marrë përgjigje se duhet që pranë kësaj Gjykate ta dërgojmë numrin e Xhirollogarisë së Debitorit **Gjevat Spahija**.

Është bërë Parashtresë për **Prokurorinë Themelore në Prizren** me të cilën ne e njoftojmë Prokurorin se sa i përket këtij Kallëzimi Penal kundër Arsim Krasniqi, për Kompaninë tonë kjo çështje ka përfunduar pasi që ne e kemi realizuar kërkesën tonë pasurore juridike.

Është dhënë Përgjigje në Ankesë ndaj znj. Lulvere Jonuzaj lidhur me Ankesën e parashtruar nga e njëjta për mos pranim në punë të sajë por të kundër kandidatit të sajë.

Kemi dërguar në Gjykatën Themelore të Prizrenit një Parashtresë me kërkesën që të na shtyhet afati për gjetjen e adresave të Debitorëve për borxhe ndaj Kompanisë sonë, pasi që me Konkluzionet e Gjykatës na është urdhëruar që në afat prej 3 (tri) dite.

PADI TË USHTRUARA KUNDËR KOMPANISË

Me datë **03.02.2014**, është sjellë nga Gjykata Themelore në Prizren PADI, C.nr.301/13, me të cilën Paditësi GËZIM DODA, edhe tani punëtorë në KRU "Hidroregjioni Jugor" kërkon KTHIM NË VENDIN E PUNËS KU NE DETYROHEMI që në afat prej 15 ditësh nga sot (deri me datë **18.02.2014**) të japim PËRGJIGJE NË PADI.

Me datë **24.02.2014**, është sjellë nga Gjykata Themelore në Prizren THIRRJE PËR SHQYRTIMIN KRYESOR lidhur me lëndën C.nr.569/11, që me datë **19.02.2014**, ditë E MËRKURË në ora 10.30, në dhomën nr. 208, me marrë pjesë në seancë gjyqësore ndaj KREDITORIT **ERDOGAN KAQAMAKU**, KOMPENSIM DËMI. Për këtë PADI Gjykata nuk na ka obliguar që të japim Përgjigje në Padi por vetëm Thirrje për seancë gjyqësore.

Me datë **03.02.2014**, është sjellë nga Gjykata Themelore në Prizren THIRRJE PËR SHQYRTIMIN KRYESOR lidhur me lëndën P.nr.304/13, që me datë **14.03.2014**, ditë E PREMTE në ora 09.00, në dhomën nr. 204, me marrë pjesë në seancë gjyqësore ndaj **Paditësit BEDRI HOXHAI**, DËSHMITAR. Për këtë PADI Gjykata nuk na ka obliguar që të japim Përgjigje në Padi por vetëm Thirrje për seancë gjyqësore.

PËRGJIGJE NË PADI

1. Me date **18.02.2014**, është dërguar në Gjykatën Themelore në Prizren **PËRGJIGJE NË PADI-në C.nr. 301/13**, ndaj Paditësit **GËZIM DODA**.

TËRHEQJE E REVIZIONIT

1. Me datë **03.02.2014**, punonjësi **Ahmet Rama**, deri tani i larguar nga marrëdhënia e punës, pas arritjes së marrëveshjes me Kompaninë sipas së cilës i njëjti do të kthehet në punë në Kompani, **E KA TËRHEQUR** Revizionin e parashtruar në Gjykatën Supreme të Kosovës.

ANKESA NË GJYKATËN E APELIT NGA KRU

Me datë 20.03.2014, është dërguar **ANKESË** në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, kundër **AKTVENDIMIT E.nr. 684/2007**, datë **12.03.2014** të nxjerrë nga Gjykata Themelore në Prizren me të cilin është përmbuar **Propozimi për Ekzekutim** nga Debitori **ADIL QABRATI** nga Prizreni pasi që Debitori e ka bërë pagesën borxhit të krijuar pas Propozimit për Ekzekutim, ndërsa borxhin nga Padia në lartësi prej **323.57 €** e ka të pa paguar.

Me datë 20.03.2014, është dërguar **ANKESË** në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, kundër **SADRI REXHA** nga Prizreni lidhur me **AKTGJYKIMIN C.nr. 772/11**, datë **05.02.2014** të nxjerrë nga Gjykata Themelore në Prizren me të cilin është kërkuar nga Deditori në fjalë që nga borxhi i gjithmbarshëm të paguaj shumën prej vetëm **56,06 € (nga totali prej 1.209,32 €)**.

Me datë 17.03.2014, është sjellë nga Gjykata Themelore në Prizren **ANKESË** e **Prokurorit të Shtetit (PSH)** drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë kundër **AKTGJYKIMIT P.nr. 329/13**, datë **10.02.2014**, me të cilën kërkon që të njëjtin TA PRISH, dhe të njëjtin ta kthej në RIGJYKIM ose ta NDRYSHOJ, në mënyrë që **z. Gëzim Doda** TA SHPALLI FAJTOR dhe t'ia shqiptoj dënimin në kufi të minimumit dhe të maksimumit të lejuar ligjor.

Me datë 25.03.2014, është sjellë nga Gjykata Themelore në Prizren **ANKESË** nga **AVOKATI i z. GËZIM DODA**, kundër **ANKESËS** së **Prokurorit të Shtetit** lidhur me lëndën **PP.nr. 277/2012**, datë **14.03.2014**. Ne në këtë çështje nuk kemi asgjë andaj edhe nuk jemi të detyruar që të bëjmë **PËRGJIGJE NË ANKESË**.

ANKESA NË GJYKATËN E APELIT KUNDËR KRU-së

Me datë 25.03.2014, është sjellë nga Gjykata Themelore në Prizren **ANKESË** nga **AVOKATI i z. GËZIM DODA**, kundër **ANKESËS** së **Prokurorit të Shtetit** lidhur me lëndën **PP.nr. 277/2012**, datë **14.03.2014**. Ne në këtë çështje nuk kemi asgjë andaj edhe nuk jemi të detyruar që të bëjmë **PËRGJIGJE NË ANKESË**.

VENDIMET NGA GJYKATA THEMELORE NË FAVOR TË KOMPANISË

Me datë 17.01.2014, është sjellë nga Gjykata Themelore në Prizren **AKTVE-NDIM** lidhur me lëndën **C.nr. 354/08**, datë **06.01.2014**, me të cilin **KONSIDEROHET E TËRHQUR PADIA** e Paditësit **HAKI SULQANI** nga **Prizreni** kundër Kompanisë sonë pasi që Paditsi dhe as i Autorizuari i tij nuk kanë marrë pjesë në asnjë nga 2 (dy) seancat e thirrura rregullisht nga Gjykata Themelore.

Me datë 17.01.2014, në ora 10.30, kam qenë në Suharekë lidhur me lëndën **C.nr. 199/12-(Arsim Krasniqi)**-ku Gjykata Themelore ka marrë **AKTGJYKIM** me të cilin **REFUZOHET KËRKESËPADIA E PADITËSIT** për shkak të heqjes dorë nga **KËRKESËPADIA NË SEANCË GJYQËSORE**.

Me datë 23.01.2014, është sjellë nga Gjykata Themelore në Prizren **AKTVENDIM** lidhur me lëndën **C.nr. 75/2009**, datë **21.01.2014**, me të cilin **KONSIDEROHET E TËRHQUR PADIA** e Paditësit **K.R.U. "Hidroregjioni Jugor"Sh.A.** nga **Prizreni** kundër **KUJTIM KRASNIQI** nga Prizreni, për shkak të **PËRJASHTIMIT NGA EKZEKUTIMI**.

Me datë **28.01.2014, ditë E MARTE në ora 11.00, në dhomën nr. 222**, në seancën gjyqësore lidhur me lëndën **C.nr.262/10**, ndaj **PADITËSIT SHABAN KURTAJ**, lidhur me **VËRTETIMIN E PRONËSISË**, nga i Autorizuari i tij me precizim të Padisë ka hequr dorë nga Padia ndaj nesh.

Me datë 06.02.2014, është sjellë nga Gjykata Themelore në Prizren **AKTGJYKIM lidhur me lëndën c.nr. 628/10**, datë **23.01.2014**, me të cilin obligohet I PADITURI **QAZIM QUNAJ**, F. Nashec ta paguaj BORXHIN NË LARTËSI prej **393,96 €** së bashku me shpenzimet procedurale në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit.

Me datë 24.02.2014, është sjellë nga Gjykata Themelore në Prizren **AKTVENDIM lidhur me lëndën C.nr. 569/11**, me të cilin KONSIDEROHET se Padia e Padiësit **ERDOGAN KAQAMAKU** ËSHTË TËRHEQUR, pasi që Padiësi nuk ka ardhur në seancën gjyqësore edhe pse i ftuar rregullisht.

Me datë 28.02.2014, është sjellë nga Gjykata Themelore në Prizren **AKTGJYKIM lidhur me lëndën P.nr. 176/20013**, datë **14.02.2014**, me të cilin I PANDEHURI **ARSIM KRASNIQI**, F. Savrovë KK Suharekë është shpallur fajtorë dhe është dënuar me 6 (gjashtë) muaj burg, respektivisht të njëjtin Gjykata ja ka shndërruar në **DËMIN ME TË HOLLA** në lartësi prej **3.000.00 (Tremijë) €**, që ti paguaj në afat prej 6 (gjashtë) muajve nga **500.00 €** rata mujore pasi që i njëjti i ka paguar Dëmin e shkaktuar Kompanisë sonë në lartësi prej **4.155.41 €**.

Me datë **11.03.2014**, është sjellë nga Gjykata Themelore në Prizren **AKTGJYKIM lidhur me lëndën C.nr. 772/11**, datë **05.02.2014**, me të cilin obligohet I PADITURI **SADRI REXHA**, nga Prizreni, që ta paguaj **BORXHIN NË LARTËSI prej 56,06 € (nga totali prej 1.209,32 €)** së bashku me kamatë vjetore dhe shpenzimet procedurale në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit.

Me datë 17.03.2014, është sjellë nga Gjykata Themelore në Prizren **AKTGJYKIM lidhur me lëndën P.nr. 349/2011**, datë **25.02.2014**, me të cilin **SHEFIT KRASNIQI DHE RRAHMAN BASHA (Vepra Penale – VJEDHJE NË TENTATIVË dhe bashkëkryerje)**, që të dy banor të Prizrenit, **SHPALLEN FAJTORË** dhe dënohen me nga **100 €** dhe shpenzimet Gjyqësore.

KUNDËRSHTIMET NGA KONSUMATORËT DEBITOR

Me 18.03.2014, është sjellë nga Gjykata Themelore në Prizren **KUNDËRSHTIM** nga Debitori **Enver Xheladini** nga Prizreni të parashtuar kundër Propozimit për Lejimin e Ekzekutimit E.nr. 642/05, për borxhin në lartësi prej **580.47 €** nën arsyetimin e parashkrimit të borxhit.

Me 31.03.2014, është sjellë nga Gjykata Themelore në Prizren **KUNDËRSHTIM** nga Debitori **TEFIK MAKSUTI** për prindin e tij **MALIQ MAKSUTI** lidhur me lëndën **EKZ.nr. 675/05**, datë **05.09.2005**, ku i njëjti thirret në vdekjen e prindit si dhe në vjetërsimin e kërkesës për realizimin e borxhit

VENDIMET NGA GJYKATA THEMELORE KUNDËR KOMPANISË

Me 18.03.2014, me datë 23.01.2014, është sjellë nga Gjykata Themelore në Prizren **AKTVENDIM lidhur me lëndën C.nr. 75/2009**, datë **21.01.2014**, me të cilin **KONSIDEROHET E TËRHQUR PADIA** e Padiësit **K.R.U. "Hidroregjioni Jugor" Sh.A.** nga Prizreni kundër **KUJTIM KRASNIQI** nga Prizreni, për shkak të **PËRJASHTIMIT NGA EKZEKUTIMI**, ku edhe Gjykata Supreme e Kosovës e ka **HUDHË poshtë Revizionin e Kompanisë sonë**.

Me datë **17.03.2014**, është sjellë nga Gjykata Themelore në Prizren **AKTGJYKIM lidhur me lëndën P.nr. 329/13**, datë **10.02.2014**, me të cilin I AKUZUARI **GËZIM DODA**, nga Prizreni, **LIROHET NGA AKUZA**.

KONKLuzion

Me datë **19.03.2014**, janë sjellë nga Gjykata Themelore në Prizren 16 (Gjashtëmbëdhjetë) **KONKLuzionE** (E.nr. **511/05**, E.nr. **556/05**, E.nr. **514/05**, E.nr. **646/05**, E.nr. **224/05**, E.nr. **544/05**, E.nr. **681/05**, E.nr. **645/05**, E.nr. **310/06**, E.nr. **328/06**, E.nr. **1355/06**, E.nr. **330/06**, E.nr. **333/06**, E.nr. **695/07**, E.nr. **674/07**,

E.nr. 655/07), me të cilat është kërkuar që në afat prej 3 (tri) ditësh kësaj Gjykate ti ofrohen të dhëna shtesë lidhur me Adresat e sakta të konsumatorëve nën kërcënimin e hedhjes poshtë të Propozimeve për ekzekutim.

Për 15 (pesëmbëdhjetë) Konkluzione i është dhënë përgjigje kësaj Gjykatë ndërsa për 1 (një) Konkluzion nuk ka pasur informatë shtesë lidhur me vendndodhjen e konsumatorit.

NDËRPRERËJET E PROCEDURAVE SI PASOJË E VDEKJES SË DEBITORËVE

Në këtë tremujorë nuk kemi pasur ndonjë rast të ndërprerjes së procedurave gjyqësore si pasojë e vdekjes së debitorëve.

Masat e ndërmarra nga Gjykata Themelore në Prizren lidhur me Paditë e bëra nga KRU për kyqjen ilegale të konsumatorëve për periudhën kohore Janar - Mars 2014

Gjatë periudhës kohore Janar - Mars 2014, nga Gjykata Themelore, **Divizioni për Kundërvajtje** në Prizren, janë shqyrtuar gjithsej **19 (nëntëmbëdhjetë) Fletëparaqitje për kyqje apo rikyqje ilegale.**

1. Për **2 (dy)** Kërkesa është shqiptuar **masa – hedhet poshtë**;
2. Për **1 (një)** Kërkesë është shqiptuar **masa – pezullim**;
3. Për **16 (gjashtëmbëdhjetë)** Kërkesa është shqiptuar **masa e dënimit në të holla**, ku shuma totale e dënimeve e kap shifrën e **1510,⁰⁰ € (një mijë e pesëqindtë e dhjetë) Euro.**

Tremujori i IV-të	Masa e qortimit	Hidhet poshtë	Masa e pezullimit	Masa e dënimit në Euro	Të kryera gjithsej	Shuma totale e dënimeve në E
Janar	/	/	/	16	16	1510.⁰⁰ €
Shkurt	/	/	/	/	/	/
Mars	/	2	1	/	3	/
Totali	0	2	1	16	19	1510.⁰⁰ €

Paraqitja tabelore e Vendimeve të lëshuara nga Ankesat e konsumatorëve

Muaji	Sasia e Vendimeve të lëshuara	Vërejtje
Janar	46	
Shkurt	28	
Mars	58	
Totali	132	

Gjatë këtij tremujori janë shqyrtuar edhe Ankesat e konsumatorëve të cilat në total janë 132 (njëqindtë tridhjetë e dy) Ankesa.

Ankesat e konsumatorëve janë shqyrtuar në aftin optimal nga Komisioni për shqyrtimin e Ankesave të Konsumatorëve ku janë nxjerrë Vendime dhe të njëjtat u janë dërguar konsumatorëve.

4.2 Raport rreth punës së zyrës së teknologjisë informative për janar - mars 2014

1.Përshkrimi hyrës;

Aktivitetet e punës së përditshme detalisht janë pasqyruar në raportet ditore të cilat plotësohen në fund të orarit të punës. Këto raporte janë të gatshme në çdo kohë të prezantohen para autoriteteve dhe udhëheqësve të Kompanisë.

Janë disa angazhime të përditshme që ekzekutohen konform detyrimeve të vendit të punës për operim dhe funksionimit optimal të sistemit në përgjithësi dhe të cilat nuk evidentohen çdo herë në raporte për shkak të përsëritjes.

Prandaj ky raport shtron kryesisht aktivitetet e përmbledhura duke veçuar ndonjë punë ekzekutuese që ka patur peshe dhe ndikim të veçantë.

Në konsultë me Menaxherin, kam përpiluar një pasqyrë ditore raportuese për evidentim të aktiviteteve të përditshme e cila e njëjta do të shërben për përpilimin e raporteve periodike dhe vjetore.

2.Raporti

- Asistencë profesionale për funksionimin normal dhe optimal të rrjetit kompjuterik në bazë dhe në njësi të kompanisë.
- Nderhyrje në njësinë e Malishevës (print, server, vpn router, klient) : 27 herë.
- Nderhyrje në njësinë e Therandës (print, server, vpn router, klient) : 26 herë.
- Nderhyrje në njësinë e Dragashit (print, server, vpn router, klientë): 16 herë.
- Nderhyrje në njesitë (Shatërvan, Depo, Koagolatorë) : 50 herë.
- Nderhyrje në Bazë (print, server, vpn router, klientë, fotokopje) : 306 herë.
- Përkujdesje për qasjen e kompanisë në rrjetin e internetit.
- Përkujdesje për menaxhimin dhe mbarëvajtjen e punës së serverit qendror, programit NAVISION, serverave të Njësive, serverit të GIS sistemit dhe sigurisë së të dhënave.
- Asistencë teknike për funksionimin normal të rrjetit telefonik lokal dhe fiks.
- Riparim harvderik dhe softverik të paisjeve kompjuterike, programeve aplikative operacionale që shfrytëzohen në Kompani.
- Kemi ndertuar Ëeb faqen e kompanisë Hidroregjioni Jugor.
- Kemi porositur një server IBM të ri.
- Kemi vendosur 4 kamera në njesinë Malisheve
- Kemi shtuar role të reja në Servere (DNS 2, DHCP)
- Kemi krijuar arka dhe përdorues të rinjë, në përputhje me kërkesat e kompanisë.

3.Komentet dhe vërejtjet,

- Mikroserveret e vendosur nëpër njësi janë duke u përdorur si backup serverë.
- Racku i sjelle nga USAID e që ka kushtuar 1000 Euro nuk është në shfrytëzim.
- Zgjidhja e problemeve me kontraktorin për furnizimi me paisje të IT. Kemi shumë vonesa në marrjen e paisjeve që po i porosisim.
- Ka mbetur Depo (Mulliri), Arka e vendosur në zyrat e komunes së Malisheves, pa e kyqe në database për shkak të mungesës së paisjes VPN Router.
- Kabineti ekzistues kompjuterik nuk është në gjendje optimale sa i përket sistemit kabllovik, koneksioneve, ventilimit, sigurisë, burimit energjetik e të ngjajshme.
- Është ndaluar rregullimi i paisjeve personale të punetoreve të kompanisë
- Shenimet për ëeb faqe.

4.Propozimet – kërkesat

- Mikroserveret e vendosur nëpër njësi të konfigurohen për funksion në bazen e konsultës me menaxherët kompetent.
- Kompletimi dhe sjellja e rregullt e shenimeve për ëeb faqe. Meqenese ëeb faqja eshte ndertuar ne ate menyre qe aktualitetet, oraret e reduktimeve, aktivitetet e prokurimit, dokumentet duhen perditesuar, atehere duhet të ketë azhurnim të përditshëm apo sipas aktualiteteve nga shërbimet perkatese.
- Organizimi i nje trajnimi privat per databaze (NAVISION).
- Jam përgatitë për shumë certifikime tjera të Cisco Systems dhe Microsoft Certifications, mirëpo për shkak të obligimeve tjera nuk po mund t'i mbuloj dhe natyrisht këto kanë një kosto të parapagimit prandaj në këtë drejtim shpresoj në mbështetje të Kompanisë për pagimin e këtyre certifikimeve. Një certifikim Microsoft kushton 80 \$ mirëpo një Cisco 260 \$.
- Meqenëse depoja nuk është ende e kyqur në rrjetin e aplikacionit NAVISION kërkoj furnizimin nga kontraktuesi të VPN Routerëve për instalim në depo, zyre në KK – Malishevë dhe ngjajshëm ose të lejohet blerja direkte e tyre te furnizuesit tjerë.
- Instalimi i mëparshëm i rrjetit kompjuterik i hasur në objekt ka vendosur kabinetet kompjuterike (RACK) në korridor i cili për shkaqe sigurie dhe të tjera nuk preferohet prandaj propozoj dhe kërkoj që të sigurohet një kthinë e veçantë brenda objektit me kushte të parapara ventilimi e sigurie që kabineti i tillë bashkë me serverët në shfrytëzim dhe serverit të ri që pritet të instalohet brenda një muaji të vendoset në te. Me këtë aksion do të mënjanohej edhe vërejtja rreth gjendjes dhe sistemimit të kabineteve kompjuterike dhe sigurisë së kërkuar.
- Blerja e pasijeve të lartëshënuara nuk jane sjellur nga kontraktori, ndersa porosia eshte bere para 7 muajve.
- Blerja e nje Cisco Fireëall ASA per sigurimin e rrjetit te kompanise.

V. RAPORT I SHËRBIMIT FINANCIAR

5.1 Aktivitetet Janar-Mars 2014

Aktivitetet nga shërbimi financiar për muajin mars:

- Përgatitja e draft pasqyrave financiare për vitin 2013
- Kontrollimi dhe barazimi i llogarive të pagueshme;
- Takim me auditorin e jashtëm dhe fillimi i punës së auditimit nga auditorët në shërbimin e financave;
- Raportet ditore nga shërbimi i arkës, gjendjen e arkës në lidhje me inkasimet ditore, ato të amvisërisë, bizneseve, gjendjen e llogarive bankare;
- Kontrollimi dhe nënshkrimi i kërkesave për blerje,
- Kontrollimi dhe nënshkrimi i faturave për blerjet si dhe regjistrimi i tyre në kontabilitet;
- Rifreskimi i shënimeve; të pagueshmet dhe të arkëtueshmet
- Kontrollimi i borxheve të konsumatoreve dhe borxhet ndaj furnitorëve si dhe pagesa ndaj tyre.
- Përgatitja e raporteve mujore; faturimi, inkasimi dhe shpenzimet; ZRRUK, etj
- Takime me kryeshefin lidhur me performancën e muajit të kaluar të kompanisë si dhe takime me menaxherët e njësisë.
- Raportet ditore me shërbimet brenda departamentit të financave si dhe brenda ndërmarrjes;
- Takim me menaxhmentin e kompanisë, me shërbimet përkatëse, etj

5.2 Shpenzimet Janar-Mars 2014

Shpenzimet operative të ndërmarrjes për tre mujorin e parë të 2014, në krahasim me shpenzimet e tremujorit të fundit të vitit të kaluar, kanë qenë më të ulëta, por që mbulueshmëria ka qenë më e ulët. Më poshtë do t'i cekim disa nga arsyet dhe ndryshimet në disa nga pozicionet kryesore të shpenzimeve.

Së pari shpenzimet si total në këtë tre mujor janë më të ulëta, edhe pse aktivitetet operative dhe investuese kanë vazhduar edhe në këtë fillim vit.

Nëse nisemi në pozicionin e pagave, shpenzimet për këtë pozicion kanë qenë pothuajse të njëjta, me një rritje të vogël me arsyen se është rritur edhe numri i punëtorëve.

Te shpenzimet e energjisë elektrike kemi një rritje të tyre, pra i vetmi pozicion që ka pësuar një rritje më të madhe, sepse investimet për gjetje të burimeve të reja kanë vazhduar dhe kjo ka ndikuar edhe në shtimin e pompave të reja, gjë që ka ndikuar direkt edhe në rritjen e energjisë elektrike.

Te pozicioni i derivative nuk kemi ndonjë ndryshim, por kemi një rënie të vogël të shpenzimeve për derivate. Edhe te mirëmbajtja, kemi një rënie të shpenzimeve, pra nevoja për intervenime në rrjet dhe mirëmbajtje të pompave ka qenë më e ulët në këtë tre mujor në krahasim me tremujorin e fundit.

Pra, investimet tona janë duke vazhduar në gjetjen e burimeve të ujit, ndërtimin e rezervuarve të rinië të ujit si dhe në instalimin e rrjetit të ri për disa rrugë, të cilat investime do të ndikojnë direkt në rritjen e furnizimit me ujë të pijshëm të të gjithë qytetarët si dhe në mirëmirëqenjen e tyre.

5.3 RAPORTI I PERFORMANCES – TM1-2013 – TM1- 2014

• NJËSIA PUNUESE – PRIZREN

MUAJI	TM1-2013	TM1-2014	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI %
Prodhimi m3	3,676,805	3,245,450	(431,355)	-11.73
Faturimi m3	1,433,633	1,260,063	(173,570)	-12.11
Faturimi nga uji €	761,189.31 €	697,262.49 €	- 63,926.82 €	-8.40
Faturimi- te tjera €	10,540.00 €	10,804.85 €	264.85 €	2.51
Faturimi Total €	771,729.31 €	708,067.34 €	- 63,661.97 €	-8.25
Inkasimi nga uji €	560,307.48 €	586,382.76 €	26,075.28 €	4.65
Inkasimi - te tjera €	11,007.28 €	7,203.85 €	- 3,803.43 €	-34.55
Inkasimi Total €	571,314.76 €	593,586.61 €	22,271.85 €	3.90
Nr. i Konsumatorëve	28700	29,732	1032	3.60
% e inkasimit	73.61	84.10	10.49	14.25
Shpenzimet	593,543.18 €	599,214.87 €	5,671.69 €	0.96
Uji I pafaturuar në m3	2,243,172	1,985,387	(257,785)	-11.49
Uji I pafaturuar ne %	61.01	61.17	0.16	0.27
Mbulimi operativ	0.96	0.99	0.03	2.91

KOMENTET FINANCIARE

- Nëse krahasohet TM1 2013 me TM1 2014, kemi një rënie të faturimit prej 173,570 m³ ujë . Arsye kryesore të kjo rënie është faturimi i institucioneve. Me kërkesë të tyre është rrit faturimi në TM4 2013 për arsye të parapagimit të shpenzimeve të ujit (kryesisht shkollat në Prizren).Arsye tjetër është rritja e numrit të konsumatorëve të cilët kanë vendos ujëmatës (tani shpenzimet kanë rënë

pasi faturimi paushall te këta konsumatorë ka qenë dy herë më i madh). Në muajt në vazhdim pritet rritje e konsumit të ujit.

- Numri i konsumatorëve ka trend të rritjes si rezultat i rritjes së ofrimit të shërbimeve tek konsumatorët, zbulimit dhe regjistrimit të konsumatorëve ilegal . Në fund te TM1 2014 janë faturuar 1032 konsumatorë më tepër në krahasim me fundin e TM1 2013.

KOMENTET: -

*Gjatë periudhës të TM-1 ka pasur rrënje të prodhimit të ujit prej 431,355 m³ ose 11.73 % , me shtimeve te kapaciteteve të reja kemi arritur në këtë periudhë të mbajmë gjendje stabile te furnizimit me ujë.

Uji i pa faturuar edhe gjatë TM-1 te vitit 2014 është përcjell sikurse nga TM-1 të vitit paraprak me një ndryshim prej 0.16%.

ARSYET QË KANË NDIKUAR NË ARRITJEN-MOSARRITJEN E OBJEKTIVAVE

*Një prej arsyeve që ka ndikuar ne mos arritjen e objektivave është keqpërdorimi i ujit nga ana e qytetarëve, defekteve ne sistemin e ujësjellësit 221 raste dhe defekte të kanalizimit 109 raste.

*Numri i madh rrjedhjeve në pjesën e nënklasë ku janë të pa banuar, konsumatorët janë komuniteti Serb si dhe për shkak te rrjetit të vjetërsuar, lidhjet ilegale etj.

*Mos plotësimi i limitit nga ana e disa Inkasantëve.

MASAT E PROPOZUARA PËR PËRMIRËSIMIN E PERFORMANCËS

*Angazhimet shtesë te ekipes se kontrolles dhe te ekipes së detektimit ku kanë detektuar gjithsej 4131 raste ku kanë gjetur 74 defekte si dhe kanë detektuar 14.421 metra, si dhe janë në koordinim me të gjitha shërbimet.

*Vetëdijesimi i qytetarëve për shfrytëzimin e drejt te ujit të pijes, duke mos e keqpërdorur, dhe të jenë të përgjegjshëm në pagesa ndaj shërbimit të Kompanisë.

*Aplikimi i ç'kyçjeve individuale ndaj konsumatorëve te papërgjegjshëm, reduktime për lagjet/fshatrat qe nuk i kryejn obligimet ndaj Kompanisë

*Bashkëpunimi me institucionet – Kuvendin Komunal etj.

*Procedimi për në gjykatë të keqpërdoruesve (lidhjet ilegale, mospagesë, etj)

RAPORTI I PERFORMANCES – TM1-2013 – TM1- 2014

• NJËSIA PUNUESE – SUHAREKË

MUAJI	TM1-2013	TM1-2014	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI %
Prodhimi m3	453,982	516,305	62,323	13.73
Faturimi m3	188,692	184,881	(3,811)	-2.02
Faturimi nga uji €	104,518.18 €	101,745.79 €	- 2,772.39 €	-2.65
Faturimi- te tjera €	3,161.07 €	3,408.41 €	247.34 €	7.82
Faturimi Total €	107,679.25 €	105,154.20 €	- 2,525.05 €	-2.34
Inkasimi nga uji €	50,645.39 €	61,828.63 €	11,183.24 €	22.08
Inkasimi - te tjera €	3,675.93 €	3,409.49 €	- 266.44 €	-7.25
Inkasimi Total €	54,321.32 €	65,238.12 €	10,916.80 €	20.10
Nr. i Konsumatorëve	3667	4,902	1235	33.68
% e inkasimit	48.46	60.77	12.31	25.41
Shpenzimet	73,398.30 €	97,073.48 €	23,675.18 €	32.26
Uji I pafaturuar në m3	265,290	331,424	66,134	24.93
Uji I pafaturuar ne %	58.44	64.19	5.76	9.85
Mbulimi operativ	0.74	0.67	-0.07	-9.19

KOMENTET-

Gjatë TM1 2014 ka pasur një rritje të prodhimit të ujit për 62,323 [m³], në raport me TM-1 të vitit 2013, Uji i faturuar në TM1 2014, ka shënuar rënie për vlerën prej 3.811[m³], ose -2.02[%] krahasuar nga TM-1 të viti 2013

ARSYET QË KANË NDIKUAR NË ARRITJEN/MOSARRITJEN E OBJEKTIVAV

- *Mos plotësimi i limitit nga ana e Inkasantëve.
- *Mospagesa e faturave nga një pjesë e Institucioneve.
- *Zvogëlimi i sasisë së ujit në fshatin Studenqan si pasojë e thatësisë që ka mbretëruar në këtë periudhë si dhe furnizimi i pamjaftueshëm në fshatin Dobërdelan.
- *Pamundësia e shkyçjeve të konsumatorëve që nuk paguajnë faturat e ujit për shkak të shkaqeve objektive, siç është dëmtimi i rrugëve etj.
- *Rritja e shpenzimeve të rrymës në këtë tremujor si pasojë e tarifës dimërore.

MASAT E PROPOZUARA PËR PËRMIRËSIMIN E PERFORMANCËS

- * Përgjegjësi dhe korrektësi të plotë në teren e Inkasantëve dhe ekipit të Kontrollës, në leximin e rregullt të ujëmatësve, shpërndarjen e të faturave, zbulimin e lidhjeve ilegale në rrjet etj.
- *Ngritja e vazhdueshme e nivelit të profesionalizmit dhe të përgjegjësisë në punë e shërbimit për konsumatorë, siç është faturimi i dyfishtë, mbingarkimi, faturimi paushall i konsumatorëve,
- *Rritja e presionit ndaj Institucioneve komunale dhe bizneseve të cilët nuk i kryejnë obligimet ndaj Kompanisë tonë.
- *Bashkëpunimi me mediat lokale në sensibilizimin konsumatorëve në veçanti dhe opinionit publik në përgjithësi, mbi domosdoshmërinë e shfytëzimit sa më racional të ujit,
- *Bashkëpunimi me Organet udhëheqëse komunale dhe Inspektoratin në arritjen e këtyre objektivave qoftë edhe duke e kushtëzuar pagesën e ujit me ndonjë shërbim komunal, për çka jemi në koordinim të plotë edhe me Kryetarin e Komunës, për të gjetur një zgjidhje të pranueshm.
- *Bashkëpunimi me Organet udhëheqëse komunale si Drejtoria e shërbimeve publike për punet që po zhvillohet në Sallagrazhdë, në vendin e quajtur „Te krismat e Sali Shabanit“, i cili projekt do të siguroj sasi të konsiderueshme të ujit të pijes për shumë vendbanime të Komunës sonë dhe njëkohësisht, në masë të madhe do t'i reduktoj shpenzimet, të rrymës që do të ndikojë dukshëm në rritjen e performancës pozitive në njësinë tonë.
- *Përfundimi i ndërtimit të Kaptazhës së re të ujit të burimi në Studenqan, pas hulumtimit dhe sigurimit të një sasive dukshëm më të madhe të ujit të pijes, ashtu që do të stabilizohet furnizimi si dhe do të rritet inkasimi.
- *Furnizimi pa reduktime i fshatit Dobërdelan, që tashmë ka përfunduar projekti, kemi furnizim të plotë me ujë dhe presim inkasim dukshëm më të mirë.

RAPORTI I PERFORMANCES – TM1-2013 – TM1- 2014

• NJËSIA PUNUESE – DRAGASH

MUAJI	TM1-2013	TM1-2014	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI %
<i>Prodhimi m3</i>	103,574	97,310	-6,264	-6.05
<i>Faturimi m3</i>	53,204	47,820	-5,384	-10.12
<i>Faturimi nga uji €</i>	34,701.08 €	31,868.24 €	- 2,832.84 €	-8.16
<i>Faturimi- te tjera €</i>	723.91 €	33.00 €	- 690.91 €	-95.44
<i>Faturimi Total €</i>	35,424.99 €	31,901.24 €	- 3,523.75 €	-9.95
<i>Inkasimi nga uji €</i>	25,257.55 €	26,798.20 €	1,540.65 €	6.10
<i>Inkasimi - te tjera €</i>	723.90 €	32.98 €	- 690.92 €	-95.44
<i>Inkasimi Total €</i>	25,981.45 €	26,831.18 €	849.73 €	3.27
<i>Nr. i Konsumatorëve</i>	1086	1,346	260	23.94
<i>% e inkasimit</i>	72.79	84.09	11.30	15.53
<i>Shpenzimet</i>	26,584.25 €	30,244.36 €	3,660.11 €	13.77
<i>Uji I pafaturuar në m3</i>	50,370	49,490	(880)	-1.75
<i>Uji I pafaturuar ne %</i>	48.63	50.86	2.23	4.58
<i>Mbulimi operativ</i>	0.98	0.89	-0.09	-9.23

Komentet: TM-1/2013 - TM-1/2014

*Prodhimi i ujit ka pasur rënie sepse nevojat për konsum të ujit kanë qenë më të ultë se në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

*Faturimi ka qenë më i ulët sepse prodhimi i ujit për konsumatorët ka qenë më i ulët ndërsa faturimet e tjera kanë pasur rënie për arsye se nuk janë paraqitur nevoja për shërbime të tjera në njësi.

*Inkasimi në përgjithësi ka qenë stabil dhe ka pasur rritje në përqindje.

*Numri i konsumatorëve është rritur për 260 konsumator të ri sepse ka pasur kyçje të reja të konsumatorëve në ujësjellës si dhe është marrë në menaxhim fshati Brezne.

*Shpenzimet në tremujor janë rritur në krahasim me vitin e kaluar sepse ka pasur aktivitete të shtuara gjatë marrjes në menaxhim të fshatit Brezne.

*Uji i pafaturuar ka qenë përafërsisht i njëjtë me vitin e kaluar ku si shkaktar i humbjeve të ujit është një pjesë e rrjetit të stërvjetruar të ujsjellësit.

*Mbulimi operativ ka qenë përafërsisht i njëjtë me vitin e kaluar me në ramje të lehtë rezultat i së cilës janë shpenzimet e bëra në aktivitetet e marrjes në menaxhim të fshatit Brezne.

Realizimi i caqeve- Komentet:

*Prodhimi i ujit ka pasur rënje sepse gjatë periudhës së marrjes në menaxhim të fshatit Brezne rreth një muaj janë vendosur ujjat tek konsumatorët dhe gjatë kësaj periudhe nuk janë rexhistruar shpenzimet e ujit.

*Faturimi ka qenë më i ulët sepse kërkesat kanë qenë më të vogla dhe uji i shpenzuar për rreth një muaj në fshatin Brezne nuk është faturuar.

*Inkasimi ka pasur rritje e kjo ka qenë si rezultat i angazhimeve të vazhdueshme në rritjen e inkasimit dhe ngritjen e performancës në njësi.

*Numri i konsumatorëve është rritur përafërsisht me caqet e parapara por nuk është arritur numri i planifikuar i konsumatorëve sepse një numër i konsumatorëve të lagjes së fshatit Shajne dhe të fshatit Brezne që janë jashë vendit nuk janë kyqur në rrjet.

*Shpenzimet kanë qenë më të ulta sepse nuk janë paraqitur defekte në rrjet si dhe jemi angazhuar vazhdimisht në zvoglimin e shpenzimeve.

*Uji i pafaturuar ka pasur rënje si rezultat i eliminimit të defekteve në rrjet si dhe mosparaqitjes së defekteve të reja.

*Mbulimi operativ ka pasur një rënje të lehtë si rezultat i shpenzimeve të krijuara gjatë aktiviteteve në lagjen e fshatit Shajne dhe në fshatin Brezne.

RAPORTI I PERFORMANCES – TM1-2013 – TM1- 2014
• NJËSIA PUNUESE – MALISHEVË

MUAJI	TM1-2013	TM1-2014	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI %
<i>Prodhimi m3</i>	323,040	336,952	13,912	4.31
<i>Faturimi m3</i>	121,656	165,382	43,726	35.94
<i>Faturimi nga uji €</i>	73,046.56 €	86,693.91 €	13,647.35 €	18.68
<i>Faturimi- te tjera €</i>	2,942.16 €	4,823.76 €	1,881.60 €	63.95
<i>Faturimi Total €</i>	75,988.72 €	91,517.67 €	15,528.95 €	20.44
<i>Inkasimi nga uji €</i>	49,906.16 €	52,112.53 €	2,206.37 €	4.42
<i>Inkasimi - te tjera €</i>	3,263.14 €	4,995.93 €	1,732.79 €	53.10
<i>Inkasimi Total €</i>	53,169.30 €	57,108.46 €	3,939.16 €	7.41
<i>Nr. i Konsumatorëve</i>	3372	3,644	272	8.07
<i>% e inkasimit</i>	68.32	60.11	-8.21	-12.02
<i>Shpenzimet</i>	62,959.59 €	71,388.07 €	8,428.48 €	13.39
<i>Uji I pafaturuar në m3</i>	201,384	171,570	(29,814)	-14.80
<i>Uji I pafaturuar ne %</i>	62.34	50.92	-11.42	-18.32
<i>Mbulimi operativ</i>	0.84	0.80	-0.04	-5.27

KOMENTET: AKTIVITETET JANAR-MARS/2014 –MALISHEVË

Furnizimi me ujë : i plotë dhe pandërprerje gjatë 24 orëve për të gjithë konsumatorët në të gjitha zonat e furnizimit.

*Kualiteti i ujit : Gjatë periudhës Janar-Mars/2014 janë marrë 15 mostra të ujit(fiziko- kimike

dhe bakteriologjike k të gjitha ju përgjigjen standardeve të OBSH.

*Marrëveshja me Kryetarin e K.K. të Malishevës për realizimin e projektit të Senikut –Hulumtimi i burimeve të ujit për furnizim me ujë të 12 fshatrave të Komunës së Malishevës në vlerë 150.000 €.

*Marrja në menaxhim e ujësjellësit të fshatit Shkozë, rregullimi i defekteve në ujësjellës dhe kanalizim

ARËSYET QË KANË NDIKUAR NË ARRITJEN – MOSARRITJEN E OBJEKTIVAVE

*Rritja e prodhimit të ujit si dhe e faturimit në m3 - si rezultat i rritjes së nr .të konsumatorëve

*Faturimi në euro përputhet me caqet e planifikuara sipas PB,

*Inkasimi në euro është për 5.580.59 € më i ulët se planifikimi me PB,- mosrealizimi i normës së inkasimit nga 2 inkasant veqmas inkasanti = Fazli Kastrati,

*Mospagesa e faturave të muajit shkurt nga institucionet (5.822.29 €).

*Shpenzimet më të larta në Energji elektrike për shkak të rritjes së nevojave për ujë ,tarifës dimërore,si dhe i gjith sistemi është me pompa ,defektet e shumëta në rrjet (79),duhet pjesë montuese.

*Ulja e ujit të pafaturuar (18.32%) –rezultat i zbulimit të kyqjeve ilegale,leximit të sakt të ujëmatësave dhe evitimit me kohë të defekteve.

*Shkalla e lartë e papunësisë ,dhe numri i madhë i konsumatorëve- raste sociale.

*Vështirësitë e shumëta në teren për ti shkyqur konsumatorët me borgje,

MASAT E PROPOZUARA PËR PËRMIRËSIMIN E PËRFORMANCËS

*Ulja e shpenzimeve operative ,si dhe të energjisë elektrike –duke ndalur pompat 4 orë gjatë ditës kur tarifa është e lartë,

*Shkyqja e të gjithë konsumatorëve që nuk paguajnë së paku faturën mujore,

*Paisja e të gjithë konsumatorëve me ujëmatës (100%),

*Leximi i saktë i ujëmatësave,

*Kushtëzimi nga Komuna –lëshimi i dokumenteve me pagesën e ujit,

*Bashkëpunim më i mirë me PK (policinë e kosovës) dhe inspektorët komunal,

*Dërgimi i lëndëve në gjykatë për k.ilegale dhe konsumatorët me borgje të mëdha,

*Mbulimi i rasteve sociale nga Qeveria,

*Evitimi me kohë i defekteve në rrjet, zbulimi i kyqjeve ilegale,

*Largimi i punëtorëve nga puna me përformancë të dobët.

RAPORTI I PERFORMANCES – TM1-2013 – TM1- 2014
• HIDROREGJIONI JUGOR

MUAJI	TM1-2013	TM1-2014	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI %
Prodhimi m3	4,557,401	4,196,017	(361,384)	(7.93)
Prodhimi - l/sec	586	540	(46.5)	(7.93)
Faturimi m3	1,797,185	1,658,146	(139,039)	(7.74)
Faturimi l/sec	231	213	(18)	(7.74)
Faturimi nga uji €	973,455.13 €	917,570.43 €	- 55,884.70 €	(5.74)
Faturimi- te tjera €	17,367.14 €	19,070.02 €	1,702.88 €	9.81
Faturimi Total €	990,822.27 €	936,640.45 €	- 54,181.82 €	(5.47)
Inkasimi nga uji €	686,116.58 €	727,122.12 €	41,005.54 €	5.98
Inkasimi - te tjera €	18,670.25 €	15,642.25 €	- 3,028.00 €	(16.22)
Inkasimi Total €	704,786.83 €	742,764.37 €	37,977.54 €	5.39
Nr. i Konsumatorëve	36825	39,624	2799	7.60
% e inkasimit	70.48	79.24	8.76	12.43
Shpenzimet	756,485.32 €	797,920.78 €	41,435.46 €	5.48
Paga bruto	395,657.41 €	417,311.46 €	21,654.05 €	5.47
Mirmba. dhe riparimet	50,156.36 €	51,904.23 €	1,747.87 €	3.48
Rryma elektrike	234,570.91 €	252,783.48 €	18,212.57 €	7.76
Shpenzi. e derivateve	23,439.40 €	25,772.91 €	2,333.51 €	9.96
Kemikalet	276.00 €	1,638.28 €	1,362.28 €	493.58
Shpenzi. tera operat.	84,910.29 €	48,510.42 €	- 36,399.87 €	(42.87)
Uji I pafaturuar në m3	2,760,216	2,537,871	(222,345)	(8.06)
Uji I pafaturuar ne %	60.57	60.48	-0.08	(0.14)
Uji I pafaturuar l/sec	354.97	326.37	-28.59	(8.06)
Mbulimi operativ	0.93	0.93	0.00	(0.08)

KOMENTET FINANCIARE

- Nëse krahasohet TM1 2013 me TM1 2014, kemi një rënie të faturimit prej 139,039 m³ ujë . Rëniet në faturim shihen në secilën njësi, përveq njësis së Malishevës, e cila ka rritje në faturim në krahasim me TM1 2013. Arsyet për rënie të faturimit janë dhënë te secila njësi operative veq e veq, mirëpo si arsye kryesore është faturimi i rritur i disa institucioneve në TM4 2014 për arsye të parapagimit të shpenzimeve të ujit (kryesisht shkollat në Prizren). Arsye tjetër është rritja e numrit të konsumatorëve të cilët kanë vendos ujëmatës (tani shpenzimet kanë rënë pasi faturimi paushall te këta konsumatorë ka qenë dy herë më i madh).Në muajt në vazhdim pritet rritje e konsumit të ujit.
- Numri i konsumatorëve ka trend të rritjes si rezultat i rritjes së ofrimit të shërbimeve tek konsumatorët, zgjerimin e zonës së shërbimit (duke marr në menaxhim fshatra), gjithashtu edhe zbulimit dhe regjistrimit të konsumatorëve ilegal . Në fund te TM1 2014 janë faturu 2.799 konsumatorë më tepër në krahasim me fundin e TM1 2013.

KOMENTET:

Gjatë TM-1 të vitit 2014 ne kompanin e “Hidroregjionit Jugor” ka pasur rënje të prodhimit prej 361,384 m³ ose 7.93 % krahasuar nga TM-1 te vitit paraprak, kjo rënje të prodhimit është e lidhur me rënjen e burimeve ekzistuse, prandaj kemi arritur të kemi gjendje stabile të furnizimit me ujë falë shtimit të kapaciteteve të reja gjatë këtijë TM-1.

*Raportet tregojne qe UPF ne nivel regjional për TM-1 të vitit 2014 eshte 60.48 % ose 0.09% me pakë humbje nga TM-1 te vitit paraprak 2013, kështu që është arritur të kemi renje te ujit të pafaturuar.

ARSYET QË KANË NDIKUAR NË ARRITJEN-MOSARRITJEN E OBJEKTIVAVE

- *Mos plotësimi i limitit të inkasimit nga ana e disa inkasantëve.
- *Mospagesa e faturave nga një pjesë e Institucioneve.
- *Për mos arritjen e objektivave,janë numri i 404 defekteve ne sistemin e ujesjellesit dhe 135 defekte të kanalizimit, për shkak te rrjetit të vjetërsuar.
- *Numri i madhë i konsumatorëve –Raste sociale.
- *Shpenzimet e mëdha të rrymës elektrike.
- *Në peruidhen e dimrit konsumi i ujit bie për shfrytëzim nga ana e konsumatorëve, mirëpo edhe gjatë kësaj periudhe kemi pasur thatësira sidomos ne mujin Janar dhe Shkurt.
- *Nje prej arsye që ka ndikuar ne mos arritjen e objektivave është kundërshtimi i vazhdushëm i një pjese të konsumatorve që ti kryejn pagesat për ujin e shpenzuar.

MASAT E PROPOZUARA PËR PËRMIRËSIMIN E PERFORMANCËS

- *Angazhimet shites te ekipes se kontrolles per te verifikuar keqpërdorusit si dhe angazhimet më të mëdha te ekipes së detektimit për të gjetur rrjedhjet, duke ulur humbjet e UPF.
- *Paisja e të gjithë konsumatorëve me ujëmatës (100%).
- *Leximi i saktë i ujëmatësave.
- *Kushtëzimi nga Komuna –lëshimi i dokumenteve me pagesën e ujit.
- *Takim me inkasantet të cilit nuk i përmbushin limitin e caktuar keto takime jan mbajtur ne njesin e Suharekes,kurse pritet te mbahen takime edhe me njesin e Prizrenit dhe te Malisheves .
- *Vetëdisimi i qytetarve për shfrytëzimin e drejt te ujit të pijes, duke mos e keqpërdorur, njeherit të jenë të pëgjegjshëm në pagesa ndaj shërbimit të Kompanisë.
- *Bashkëpunimi me mediat lokale.
- *Aplikimi i ç’kyçjeve individuale ndaj konsumatorve te papëgjegjshëm, reduktime per lagjet/fshatrat qe nuk i kryejn obligimet ndaj Kompanisë.

*Rritja e presionit ndaj Institucioneve komunale dhe bizneseve të cilët nuk i kryejnë obligimet ndaj Kompanisë sonë.

5.4 REALIZIMI I CAQEVE TM1 2014

NJËSIA PUNUESE - PRIZREN

MUAJI	CAQET-TM1-2014	TM1- 2014	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI %
<i>Prodhimi m3</i>	3,675,617	3,245,450	(430,167)	-11.70
<i>Faturimi m3</i>	1,478,148	1,260,063	(218,085)	-14.75
<i>Faturimi nga uji €</i>	787,932.00 €	697,262.49 €	- 90,669.51 €	-11.51
<i>Faturimi- te tjera €</i>	10,540.00 €	10,804.85 €	264.85 €	2.51
<i>Faturimi Total €</i>	798,472.00 €	708,067.34 €	- 90,404.66 €	-11.32
<i>Inkasimi nga uji €</i>	592,696.69 €	586,382.76 €	- 6,313.93 €	-1.07
<i>Inkasimi - te tjera €</i>	10,500.00 €	7,203.85 €	- 3,296.15 €	-31.39
<i>Inkasimi Total €</i>	603,196.69 €	593,586.61 €	- 9,610.08 €	-1.59
<i>Nr. i Konsumatorëve</i>	29,268	29,732	464	1.59
<i>% e inkasimit</i>	75.22	84.10	8.88	11.80
<i>Shpenzimet</i>	658,308.12 €	599,214.87 €	- 59,093.25 €	-8.98
<i>Uji I pafaturuar në m3</i>	2,197,469	1,985,387	(212,082)	-9.65
<i>Uji I pafaturuar ne %</i>	59.79	61.17	1.39	2.32
<i>Mbulimi operativ</i>	0.92	0.99	0.07	8.11

- 55,111.43 € - 5,628.26 € 49,483.17 €

• NJËSIA PUNUESE - SUHAREKË

MUAJI	CAQET-TM1-2014	TM1- 2014	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI %
<i>Prodhimi m3</i>	453,807	516,305	62,498	13.77
<i>Faturimi m3</i>	231,991	184,881	(47,110)	-20.31
<i>Faturimi nga uji €</i>	122,465.00 €	101,745.79 €	- 20,719.21 €	-16.92
<i>Faturimi- te tjera €</i>	10,540.00 €	3,408.41 €	- 7,131.59 €	-67.66
<i>Faturimi Total €</i>	133,005.00 €	105,154.20 €	- 27,850.80 €	-20.94
<i>Inkasimi nga uji €</i>	81,701.83 €	61,828.63 €	- 19,873.20 €	-24.32
<i>Inkasimi - te tjera €</i>	8,955.27 €	3,409.49 €	- 5,545.78 €	-61.93
<i>Inkasimi Total €</i>	90,657.10 €	65,238.12 €	- 25,418.98 €	-28.04
<i>Nr. i Konsumatorëve</i>	4,665	4,902	237	5.08
<i>% e inkasimit</i>	66.71	60.77	-5.95	-8.91
<i>Shpenzimet</i>	102,327.69 €	97,073.48 €	- 5,254.21 €	-5.13
<i>Uji I pafaturuar në m3</i>	221,816	331,424	109,608	49.41
<i>Uji I pafaturuar ne %</i>	48.88	64.19	15.31	31.33
<i>Mbulimi operativ</i>	0.89	0.67	-0.21	-24.14

- 11,670.59 € - 31,835.36 € - 20,164.77 €

• NJËSIA PUNUESE - DRAGASH

MUAJI	CAQET-TM1-2014	TM1- 2014	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI %
Prodhimi m3	128,045	97,310	-30,735	-24.00
Faturimi m3	63,119	47,820	-15,299	-24.24
Faturimi nga uji €	39,679.00 €	31,868.24 €	- 7,810.76 €	-19.68
Faturimi- te tjera €	10,540.00 €	33.00 €	- 10,507.00 €	-99.69
Faturimi Total €	50,219.00 €	31,901.24 €	- 18,317.76 €	-36.48
Inkasimi nga uji €	31,012.26 €	26,798.20 €	- 4,214.06 €	-13.59
Inkasimi - te tjera €	132.00 €	32.98 €	- 99.02 €	-75.02
Inkasimi Total €	31,144.26 €	26,831.18 €	- 4,313.08 €	-13.85
Nr. i Konsumatorëve	1,381	1,346	-35	-2.53
% e inkasimit	78.16	84.09	5.93	7.59
Shpenzimet	34,393.48 €	30,244.36 €	- 4,149.12 €	-12.06
Uji I pafaturuar në m3	64,926	49,490	(15,436)	-23.77
Uji I pafaturuar ne %	50.71	50.86	0.15	0.30
Mbulimi operativ	0.91	0.89	-0.02	-2.03

- 3,249.22 € - 3,413.18 € - 163.96 €

• NJËSIA PUNUESE -
MALISHEVË

MUAJI	CAQET-TM1-2014	TM1- 2014	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI %
<i>Prodhimi m3</i>	323,741	336,952	13,211	4.08
<i>Faturimi m3</i>	133,807	165,382	31,575	23.60
<i>Faturimi nga uji €</i>	79,663.00 €	86,693.91 €	7,030.91 €	8.83
<i>Faturimi- te tjera €</i>	10,540.00 €	4,823.76 €	- 5,716.24 €	-54.23
<i>Faturimi Total €</i>	90,203.00 €	91,517.67 €	1,314.67 €	1.46
<i>Inkasimi nga uji €</i>	56,670.21 €	52,112.53 €	- 4,557.68 €	-8.04
<i>Inkasimi - te tjera €</i>	6,018.84 €	4,995.93 €	- 1,022.91 €	-17.00
<i>Inkasimi Total €</i>	62,689.05 €	57,108.46 €	- 5,580.59 €	-8.90
<i>Nr. i Konsumatorëve</i>	3,701	3,644	-57	-1.54
<i>% e inkasimit</i>	71.14	60.11	-11.03	-15.50
<i>Shpenzimet</i>	65,376.02 €	71,388.07 €	6,012.05 €	9.20
<i>Uji I pafaturuar në m3</i>	189,934	171,570	(18,364)	-9.67
<i>Uji I pafaturuar ne %</i>	58.67	50.92	-7.75	-13.21
<i>Mbulimi operativ</i>	0.96	0.80	-0.16	-16.57

- 2,686.97 € - 14,279.61 € - 11,592.64 €

• HIDROREGJIONI JUGOR -TM1 2014

MUAJI	CAQET-TM1-2014	TM1- 2014	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI %
Prodhimi m3	4,581,210	4,196,017	(385,193)	(8.41)
Prodhimi - l/sec	589	540	(49.5)	(8.41)
Faturimi m3	1,907,065	1,658,146	(248,919)	(13.05)
Faturimi l/sec	245	213	(32)	(13.05)
Faturimi nga uji €	1,029,739.00 €	917,570.43 €	- 112,168.57 €	(10.89)
Faturimi- te tjera €	42,160.00 €	19,070.02 €	- 23,089.98 €	(54.77)
Faturimi Total €	1,071,899.00 €	936,640.45 €	- 135,258.55 €	(12.62)
Inkasimi nga uji €	762,080.99 €	727,122.12 €	- 34,958.87 €	(4.59)
Inkasimi - te tjera €	25,606.11 €	15,642.25 €	- 9,963.86 €	(38.91)
Inkasimi Total €	787,687.10 €	742,764.37 €	- 44,922.73 €	(5.70)
Nr. i Konsumatorëve	39,015	39,624	609	1.56
% e inkasimit	74.01	79.24	5.24	7.08
Shpenzimet	860,405.31 €	797,920.78 €	- 62,484.53 €	(7.26)
Paqa bruto	441,502.00 €	417,311.46 €	- 24,190.54 €	(5.48)
Mirmba. dhe riparimet	57,152.00 €	51,904.23 €	- 5,247.77 €	(9.18)
Rryma elektrike	243,385.00 €	252,783.48 €	9,398.48 €	3.86
Shpenzi. e derivateve	27,688.00 €	25,772.91 €	- 1,915.09 €	(6.92)
Kemikalet	8,487.00 €	1,638.28 €	- 6,848.72 €	(80.70)
Shpenzi. tera operat.	82,191.31 €	48,510.42 €	- 33,680.89 €	(40.98)
Uji I pafaturuar në m3	2,674,145	2,537,871	(136,274)	(5.10)
Uji I pafaturuar ne %	58.37	60.48	2.11	3.62
Uji I pafaturuar l/sec	343.90	326.37	-17.52	(5.10)
Mbulimi operativ	0.92	0.93	0.02	1.68
	- 72,718.21 €	- 55,156.41 €	17,561.80 €	

KOMENTET

Nëse krahasohet TM1 2014 i planifikuar me Plan Biznes me TM1 2014 të realizuar në nivel rajonal , kemi një faturim më të vogël prej 248.919 m³ ujë . Arsye kryesore për mosrealizim të caqeve të përcaktuara në Biznes Plan është rënia e konsumit të konsumatorët e amvisërisë si dhe faturimi i institucioneve gjatë TM4 2013 për shpenzimin e muajve janar dhe shkurt 2014 . Me kërkesë të tyre është rrit faturimi në TM4 2013 për arsye të parapagimit të shpenzimeve të ujit (kryesisht shkollat në Prizren).Arsye tjetër është rritja e numrit të konsumatorëve të cilët kanë vendos ujëmatës (tani shpenzimet kanë rënë pasi faturimi paushall të këta konsumatorë ka qenë dy herë më i madh).Në muajt në vazhdim pritet rritje e konsumit të ujit si rezultat i konsumit sezonal.

Numri i konsumatorëve në krahasim me planifikimin në biznes plan është tejkaluar për 609 konsumatorë. Ky numër i konsumatorëve është rezultat i zbulimit dhe regjistrimit të konsumatorëve ilegal si dhe marrjes në menaxhim të fshatit Brezne në Dragash .

Gjatë TM-1 të vitit 2014 ne kompaninë e “Hidroregjionit Jugor” ne baze të Plan Biznesit nuk ka arritur të realizon caqet të prodhimit prej 385,193 m³ ose ka devijim të caqeve prej 8.41 % , krahasuar nga Plan Biznesi mos realizim të objektivit për prodhimin e ujit janë Prizreni me 11.70 % dhe Dragashi me 24.00% kurse realizim të caqeve kemi ne Suhareke me 13.77% dhe ne Malisheve me 4.08% . këto mos realizime të prodhimit janë për shkak të thatësirave që kanë mbretëruar sidomos në muajin Janar dhe Shkurt .

*Raportet tregojnë që UPF në nivel regional për TM-1 të vitit 2014 është 60.48 % ose 2.11% mos realizim të caqeve, kështu që kemi mos realizim të Ujit të Pa Faturuar nga Plan Biznesi në njësinë e Suharekes me 15.31% ,Prizreni me 1.39%, Dragashi 0,15% kurse vetëm Malisheva ka realizuar me zvogëlimin e Ujit të Pa faturuar me 7.75% në baze të Plan Biznesit.

ARSYET QË KANË NDIKUAR NË ARRITJEN-MOSARRITJEN E OBJEKTIVAVE

- *Mos plotësimi i limitit të inkasimit nga ana e disa inkasantëve.
- *Mospagesa e faturave nga një pjesë e Institucioneve.
- *Për mos arritjen e objektivave,janë numri i 404 defekteve në sistemin e ujësjellësit dhe 135 defekte të kanalizimit, për shkak të rrjetit të vjetërsuar.
- *Numri i madh i konsumatorëve – Rastet sociale.
- *Shpenzimet e mëdha të rrymës elektrike sidomos në TM-1.
- *Në periudhën e dimrit konsumi i ujit bie për shfrytëzim nga ana e konsumatorëve.
- *Një prej arsye që ka ndikuar në mos arritjen e objektivave është kundërshtimi i vazhdueshëm i një pjese të konsumatorëve që t’i kryejnë pagesat për ujin e shpenzuar.

MASAT E PROPOZUARA PËR PËRMIRËSIMIN E PERFORMANCËS

- *Angazhimet shtesë të ekipes së kontrolles, inkasanteve, dhe të ekipes së detektimit për të gjetur rrjedhjet, duke ulur humbjet e UPF.
- *Revidimi i Plan Biznesit – analizimi i të gjitha shtyllave.
- *Paisja e të gjithë konsumatorëve me ujëmatës (100%).

- *Leximi i saktë i ujëmatësve – eliminimin e paushallëve.
- *Kushtëzimi nga Komuna –lëshimi i dokumenteve me pagesën e ujit.
- *Takim me inkasantet të te gjitha ndjesive.
- *Vetëdijesimi i qytetarve për shfrytëzimin e drejt te ujit të pijes, duke mos e keqpërdorur.
- *Bashkëpunimi me mediat lokale – sensibilizimin e qytetareve.
- *Aplikimi i shkyçjeve individuale ndaj konsumatorëve te papërgjegjshëm.
- *Rritja e presionit ndaj Institucioneve komunale dhe bizneseve të cilët nuk i kryejnë obligimet ndaj Kompanisë sonë.

VI. RAPORT I AUDITORIT TË MBRENDSHËM

Raporti në vijim paraqet një përmbledhje të punëve dhe aktiviteteve të auditorit të brendshëm, të realizuara gjatë tremujorit të parë të këtij viti, gjegjësisht për periudhën kohore janar – mars 2014.

Sikurse në çdo tremujor të fillim vitit, edhe gjatë kësaj periudhe, fokusi kryesor i aktiviteteve të auditorit të brendshëm, është përgatitja e raporteve të cilat sipas legjislacionit në fuqi, paraqesin bazën e punës së auditorit të brendshëm. Fjala është për raportin vjetor të punës së auditorit gjatë vitit të mëparshëm, si dhe planin strategjik dhe planin vjetor të punës të auditorit për vitin aktual.

Në krahasim me punën e rregullt të auditorit, përgatitja e këtyre raporteve, konsiderohet si më specifike dhe kërkon kohë për sigurimin e të dhënave, analizimin, planifikimin dhe raportimin e tyre.

- Pra, bazuar në atë që u tha më lartë, gjatë kësaj periudhe është bërë përgatitja e Raportit Vjetor të Punës, që është realizuar gjatë vitit paraprak 2013, ku në formë të përgjithësuar, sipas auditimeve dhe subjekteve të audituara, janë prezantuar të gjitha të gjeturat, konstatimet, rekomandimet si dhe shkalla e implementimit të tyre, me çrast edhe është aprovuar nga komisioni i auditimit.

Po ashtu në pajtim me procedurat dhe standardet e auditimit të brendshëm, janë përgatitur dhe janë aprovuar nga Komisioni i Auditimit:

- Plani strategjik i punës së auditorit të brendshëm për periudhën 2014-2016;
Përmes këtij plani janë planifikuar dhe prezantuar objektivat, prioritetet dhe fushëveprimi i aktiviteteve kryesore të auditorit të brendshëm, për periudhën tre vjeçare në fjalë.

- Plani vjetor i punës së auditorit të brendshëm për vitin 2014.
Ky plan, nënkupton detyrat e auditorit të brendshëm në perspektivë, drejtimet dhe niveli i kontrollit të brendshëm, në rishikimin e rrjedhave financiare, jo financiare dhe operative, përkatësisht të gjitha proceset të cilat janë tema të auditimit për vitin 2014.

Gjithashtu në pajtim me planin vjetor të punës së auditorit si dhe me kërkesë të komisionit të auditimit, është kryer:

- Auditimi në departamentin e financave dhe të administratës, lidhur me Menaxhimin e procesit të rritjes së pagës bazë për të punësuarit në Hidroregjionin Jugor.
Me këtë rast në pajtim me procedurat e auditimit është përgatitur drafti, janë dhënë komentet si dhe është bërë finalizimi i tij.
- Pas shkresës njoftuese dhe përgatitjes së materialit, është filluar auditimi në Zyren e Prokurimit, lidhur me menaxhimin e procedurave të zhvilluara të prokurimit.
Mirëpo, vlen të theksohet se ky auditim është ndërprerë, për arsye se në të njëjtën kohë ka filluar auditimi nga Auditorët e Jashtëm, të cilët përveç tjerash në fushëveprim kanë edhe auditimin e procedurave të prokurimit. Me këtë rast, në mënyrë që të mos bëhet auditim i dyfishtë i kësaj zyreje, auditori i jashtëm ka

propozuar që ky auditim të kryhet në bashkëpunim me mua si auditor i brendshëm, gjë që kjo kërkesë është aprovuar edhe nga komisioni i auditimit. Në momentin që do të kryhet auditimi do të keni edhe raportin për të.

- Me rastin e pranimit të draft raportit të dërguar nga ana e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, lidhur me auditimin e procesit të kompensimit të Bordeve të Drejtorëve, për periudhën 2009-2012, së bashku me disa kolegë tjerë kam qenë i angazhuar në analizimin, shqyrtimin, diskutimin dhe përgatitjen e komenteve në lidhje me konstatimet të dala nga ky raport. Për rrjedhën e këtij procesi është njoftuar edhe Komisioni i Auditimit. Më duhet të theksoj se pas dërgimit të komenteve ende ne si kompani nuk kemi marrë kurrfarë përgjigje.
- Me kërkesë të Komisionit të Auditimit, është bërë rishikimi dhe është përgatitur raport lidhur me procesin e menaxhimit të projektit “Ndërtimi të Impiantit për Trajtimin e Ujërave të Zeza”, projekt ky që do të realizohet në qytetin e Prizrenit. Raporti me shkrim është prezantuar në Komision të Auditimit dhe pas shqyrtimi është aprovuar si i tillë.
- Gjatë kësaj periudhe kam filluar edhe auditimin në departamentin e financave, lidhur me Menaxhimin e të Hyrave të Kompanisë për periudhën 2013-2014. Gjatë kësaj kohe është bërë testimi dhe ekzaminimi i dokumentacionit, ndërsa raporti si draft është përgatitur në fillim të muajit prill, andaj mbetet të shqyrtohet në periudhën e ardhshme.

Në fund dua të theksoj se për të gjitha aktivitetet e kryera gjatë kësaj periudhe raportuese janar - mars 2014, ekzistojnë raporte të veçanta me shkrim, të cilat edhe janë shqyrtuar në takimet me Komisionin e Auditimit, megjithatë konsideroj se ky raport prezanton në përgjithësi, aktivitetet dhe punën e auditorit të brendshëm për periudhën në fjalë.

STRUKTURA ORGANIZATIVE
KRU „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A. PRIZREN

